

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7477 E shtunë 24 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga VALBONA MEZINI



Partia Demokratike është prona e përbashkët publike. Çudi e madhe pse kompleksohemi për të thirrur Këshillin Kombëtar e për të diskutuar çfarë ...
Vijon në faqen 20

Partia Demokratike është prona e përbashkët publike



Opinion i Ditës

Nga RAIMONDA SHUNDI

Plehat, rrugët e pamundura, shtëpitë e papërfunduara e zarzavatet e shitura në pluhur, nuk mund të shkojnë kurrsesi me peizazhin mahnitës apo ...
Vijon në faqen 21

Shqipëria, ç'është dhe ç' do të jetë



INTERVISTA

"Kur shembët kinematë, thotë se do i bënit evropiane. Sot s'i kemi më"

Alfred Trebicka: Nuk shkatërrohet teatri se është i vjetër! Po ju zoti Rama, ç'plasje keni?

"Të kërkosh transparencë të të korruptuarit? Si t'u kërkosh transparencë trafikantëve"

Nga FATMIRA NIKOLLI

Mendimi im është që ndërtimi, restaurimi apo bërja e ribërja e një institucioni siç është Teatri Kombëtar, apo edhe institucione të tjera si Teatri Kombëtar, të përmasave të tilla duhet të jenë plotësisht nisma dhe vepra ...
Në faqen 18-19

RIKTHEHEN MASKAT NE FIER. ELSA MUÇI: NA SHPETOI LLOZI I DERES. FLASIN FQINJET

15 MINUTA LUFTË MES POLICISË E GRABITESVË, VRITET I RIU

Autorët qëlluan me automatikë e pistoletë. Vdes Xhuljan Sollaku, plagoset 35-vjeçari nga Puka. E kaluara e dy djemve, dy të tjerë në kërkim



(Në foto) Xhuljan Sollaku. I plagosuri Arben Muçi. Policia në vendin e grabitjes

KUSH DO I SHQYRTOJE

Propozimet e degëve të PD: Kandidatët për deputetë të jenë minimalisht 10 vite të anëtarësuar në parti
Në faqen 7

REAGON AVOKATI

Vetingu, shkarkohet gjykatësi i Kushtetueses, Fatos Lulo, KPK: Nuk justifikon pasurinë
Në faqen 9

LIHET NE BURG

Dibër, ekzekutoi para shtëpisë biznesmenin, Mahmut Gega në gjykatë: Nuk jam unë vrasësi
Në faqen 10

KALENDARI SIPAS QYTETEVE

Matura Shtetërore, ja atatet për plotësimin e formularëve A1 e A1Z. Kush mund të aplikojë
Në faqen 11

ZONAT DHE DOKUMENTET QË DUHET TË DOREZONI



Parkimet me pagesë në Tiranë, bashkia: Pajisuni me kartën e re të rezidentit
Në faqen 11




Qindra të ftuar VIP dhe larg syve të medias, ja ku do të zhvillohet ceremonia

Sara dhe Ledioni: Së shpejti dasma "sekrete"

Flet Gena: "Me Anestin na lidhi dashuria për muzikën. Të rejat e fundit..."

Nga PAMELA ALIAJ

A ta janë padyshim një nga çiftet më të rezervuar të "showbiz"-it shqiptar. Prindër të një vogëlushi të ëmbël të quajtur London Noor, më në fund Sara Hoxha dhe Ledion Liço do të marto-



hen këtë verë. Burime për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" thanë se këtë vit, pikërisht në gusht të 2018-ës, çifti do të kurorëzojë dashurinë e tyre katërvjeçare larg syve të medias dhe kureshtarëve të tjerë. Në një ...
Suplement

TENTATIVA PER GRABITJE VRASJA

Autorët e maskuar qëlluan me automatikë e pistoleta, në kërkim edhe 2 të tjerë

Policia 15 minuta "luftë" me grabitësit, ekzekuton 20-vjeçarit Xhuljan Sollaku

Tentuan të bastisnin banesën e familjes Muçi, plagoset gjatë shkëmbimit të zjarrit 35-vjeçari nga Puka

FIER

Një tentativë grabitjeje nga një grup prej katër personash të armatosur dhe të maskuar ka përfunduar me një të vranë dhe një të plagosur. Ngjarja e rëndë si nëpër film ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në lagjen "29 Nëntori" të qytetit të Fierit. Autorët kanë shkëmbyer zjarr me policinë për afro 15 minuta, ndërkohe që ka mbetur i vranë 20-vjeçari Xhuljan Sollaku nga fshati Katund i Ri i Elbasanit si dhe është plagosur 35-vjeçari Arben Muça me origjinë nga Puka dhe banues në Durrës. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Fierit bënë me dije se katër pjesëtarët e grupit kriminal, të armatosur me automatikë dhe pistoleta kanë tentuar të hyjnë për të grabitur në banesën e shtetasit Minella Muçi. Kanë qenë të zotët e shtëpisë që kanë pikasur grabitësit dhe kanë sinjalizuar policinë. Menjëherë uniformat blu kanë shkuar në vendngjarje, por janë përballur me sulmin me armë të katër agresorëve. Grabitja ka dështuar, ndërsa janë shpallur në kërkim dy persona të tjerë, të cilët dyshohen se janë nga Fieri dhe nga Puka.

NGJARJA

Rreth orës 03:00, policia lokale u njoftua nga një telefonatë se në lagjen "29 Nëntori" Fier, pranë banesës së Minella Muçit, disa persona kanë tentuar të hyjnë brenda shtëpisë duke thyer drynin e derës. Pas marrjes së njoftimit, blutë kanë shkuar në lagjen në fjalë, por kanë ndeshur në rezistencë e grabitësve. "Në kushtet e reagimit proporcional, nga shkëmbimi i zjarrit, njëri nga autorët është plagosur dhe një tjetër ka gjetur vdekjen. Të dy ata ishin të maskuar e të armatosur me pistoleta, të cilat u sekuestruan në cilësi të provës materiale. Autorët e tjerë, që dyshohet se janë edhe dy, duke qëlluar



Xhuljan Sollaku

PRECEDENTI

Më 2 mars të këtij viti u tentua grabitja në mes të ditës së një pike të këmbimit valutor në Fier. Në këtë ngjarje mbeti i vranë me plumb në kokë Agur Vrenoz (pronari i ndërtesës), i cili tentoi të ndalojë grabitësit. Ndërsa u plagos pronari i biznesit, Gëzim Hoxha. Brenda 90 minutave policia arrestoi autorët e krimit: Zini Fyraj 37 vjeç, banues në Sevaster Vlorë (me precedent penalë); Lulëzim Demiraj, banues në Vajzë Vlorë dhe Dashmir Gergali 41 vjeç, banues në Zhupan Fier.



Vendi ku ndodhi ngjarja

BASHKËSHORTËT MUÇA

Banesa ku u tentua të grabitet është në pronësi të Minella Muçit, i cili punon si shofer dhe ndodhet në katin e tretë të një pallati në lagjen "29 Nëntori" të qytetit të Fierit. Pas ngjarjes, banorët pohan për "GSH" se Minella Muçi nuk njihet si person që kishte pasuri, por bën një jetë modeste. Çifti Muçi pikasur grabitësit që tentuan të hapnin derën dhe menjëherë njoftuan policinë, e cila mbërriti në vendngjarje.

Policia: Grupi kriminal grabiste karburante e dyqane celularësh

Nëna e të plagosurit Arben Muça: Mbrëmë isha te djali, kemi qenë të dy në shtëpi



I plagosuri Arben Muça



Pallati në Durrës ku jeton familja Muça

FIER - Zbardhen të tjera detaje në lidhje me ngjarjen e rëndë në Fier: "GSH" ishte dje në shtëpinë e 35-vjeçarit të plagosur Arben Muça, në lagjen nr.13, tek "Rrota e Kuqe" në zonën e plazhin e Durrësit. Bashkëshortja e Muçit u shpreh se të enjten kishte qenë tek babai i saj me tre fëmijët. Ndërkohë që sipas saj, i shoqi kishte fjetur në shtëpinë e tyre. "Burri im mbrëmë ka fjetur tek prindërit bashkë me tre fëmijët. Në shtëpinë tonë iku edhe nëna e tij, vjehrra ime", tha ajo. Pas kontrollave të ushtruara në banesën e 35-vjeçarit me origjinë nga Puka janë gjetur disa dokumente mjete të ndryshme, për të cilat ka dyshime se autori është hajdut makinash. Po ashtu janë gjetur edhe fatura mjete të marra me qira, si dhe disa kuti bosh të celularëve të modeleve të fundit. Ndërkohë, në py-

ar në drejtim të punonjëseve të policisë janë larguar duke përfutur nga errësira dhe kushtet e motit, me një mjet ende të paidentifikuar", thuej në njoftimin zyrtar të policisë. Fatmirësisht nga shkëmbimi me armë zjarri

nuk ka pasur të lënduar në radhët e Policisë së Shtetit. Ndërkaq, blutë kanë ngritur pika të shumta kontrolli në të gjitha hyrje-daljet e qytetit të Fierit, ndërsa po vijon puna për kapjen e autorëve të tjerë. Sipas bur-

muçës. Nga ana tjetër, fqinjët e familjes Muça u shprehën se nuk kishin njohje me të plagosurin, pasi haseshin shumë rrallë e të në pallat. "Di që gruaja e mij të shumë rri tek babai i vet në fshat, pasi e ndihmon e ëma se ka binjakë. Ndërsa, Arbeni rrinte më shumë këtu. Por, nuk e di çfarë pune bënte,

meve të mësipërme, i plagosuri Arben Muça është dërguar në Spitalin Rajonal të Fierit ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se ky i fundit ka qëndruar me kallash tek porta dhe ka hapur zjarr i pari ndaj poli-

pasi s'e kisha parë shumë", tha një prej fqinjëve, që nuk dëshoi të identifikohet. Nga të dhënat e deritanishme të grupit hetimor ka dyshime se kemi të bëjmë me një grup të strukturuar kriminal që merreshin me grabitje, kryesisht karburante dhe dyqane me telefona celularë.

cisë. Autori tjetër, Xhuljan Sollaku qëlloi me dy pistoleta ndaj policisë, por mbeti i vranë. Në vendin e ngjarjes janë sekuestruar një numër i konsiderueshëm provash materiale. Një grup i posaçëm i Prokurorisë së

HETIMET

Një grup i posaçëm i Prokurorisë së Fierit po drejton hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes së rëndë të ndodhur në lagjen "29 Nëntori" të këtij qyteti. Nga të dhënat e deritanishme të grupit hetimor, ka dyshime se kemi të bëjmë me një grup të strukturuar kriminal që merreshin me grabitje, kryesisht karburante dhe dyqane me telefona celularë.

Fierit po drejton hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Policia ka sekuestruar edhe disa kamera sigurie, por nuk dihet nëse grabitësit janë fiksuar prej tyre. Kjo është grabitja e dytë në Fier që shkakton viktima. Më 2 mars të këtij viti, në një pikë të këmbimit valutor mbeti i vranë Agur Vrenoz (pronari i ndërtesës), i cili tentoi të ndalonte grabitësit. Ndërsa mbeti i plagosur, pronari i biznesit, Gëzim Hoxha. Në lidhje me këtë ngjarje u arrestuan brenda 90 minutave autorët: Zini Fyraj 37 vjeç, banues në Sevaster Vlorë (me precedent penalë); Lulëzim Demiraj, banues në Vajzë Vlorë dhe Dashmir Gergali 41 vjeç, banues në Zhupan Fier.



ELBASAN - Xhuljano Sollaku, 20-vjeçari që mbeti i vrarë dje gjatë përplasjes me armë zjarri me policinë nuk ishte një emër i panjohur për blutë e Elbasanit. Djali i vetëm i familjes Sallaku nga Kautundi i Ri jetonte prej kohësh në Shqipëri, ndërsa motrën e kishte të martuar. Ndërkohë, nëna dhe babai i tij ishin emigrantë në Greqi. Bazuar tek burimet policore, i riu dyshohet se ka qenë autor i një sërë vjedhesh dhe grabitjesh. Sakaq, ai kishte në pronësi edhe një lavazh makinash. Po ashtu, mësohet se i riu ishte larguar nga banesa e tij në mesnatë e më pas ishte nisur për në Fier, ku do të kryente edhe grabitjen bashkë me 3 persona të tjera. Pavarësisht planit të tyre, ata u zunë në pritë nga policia, ndërsa hapën zjarr ndaj kësaj të fundit. Aktualisht prindërit e viktimës nuk

Babai i të riut, me precedentë penalë në Greqi

20-vjeçari i vrarë, pronar i një lavazhi, policia: Dyshohet të ketë qenë grabitës serial



Xhuljan Sollaku



Lavazhi në pronësi të 20-vjeçarit

ndodhen në Elbasan, ndërsa mësohet se janë nisur nga Greqia, atje ku jetojnë prej vitesh. Mësohet se edhe babai i viktimës është person me precedentë penalë, pasi

ka kryer një dënim për grabitje jashtë vendit. Trupi i pajetë i të riut është tërhequr dje nga morgu i spitalit të Fierit nga xhaxhai i tij. Lajmi për vrasjen e 20-vjeçarit ka

tronditur të dashurën e tij, e cila është shtrirë në tokë, ka filluar të ulërijë e të qajë me të madhe, ndërsa ka tentuar të shkulë edhe flokët.

Fqinjët e familjes Muçi në Fier: U terrorizuar nga krismat e armëve, nuk dolëm jashtë

Elsa Muçi: Ishim me fat, na shpëtoi llozi i derës

"U frikësuam kur dëgjuam zhurmë në derë, ndaj njoftuam policinë"

FIER

Dëgjuam zhurmë në derë dhe u frikësuam, ndaj njoftuam policinë. Ishim me fat. Na shpëtoi llozi që kishim vënë prapa derës". Kështu deklaroi dje për "Gazeta Shqiptare", Elsa Muçi, e zonja e shtëpisë që u tentua të grabitej në orët e para të mëngjesit të djeshëm. E moshuara, banuese në katin e tretë të një pallati në lagjen "29 Nëntori" të qytetit të Fierit tha se janë shokuar nga ngjarja, e cila përfundoi me vrasjen e grabitësit 20-vjeçar, Xhuljan Sollaku nga Elbasani dhe plagosjen e 35-vjeçarit Arben Muçi me origjinë nga Puka. Teksa fshinte derën kryesore të banesës që ka mbetur pa bravë dhe ku dukeshin disa njolla të zeza, Elsa Muçi tregoi momentet e tmerrit dhe atë që ndodhi. Ajo tha se grabitësit nuk mundën që të futeshin brenda në banesë, pasi dera ishte e kyçur. "Për fat të mirë e kishim mbyllur derën me lloz, pasi nuk e mbyllte asnjëherë. Shpeshherë debatoja për këtë me bashkëshortin, Minellën", pohoi e moshuara. Tejet e tronditur, ajo u shpreh: "Ata tentuan të hapnin derën, por lëviznin llozin. Unë e lë pa lloz, por Minella më bënte llafë gjithmonë. Për fat, llozi ishte i futur në beton dhe s'e hapën". Zonja



Elsa Muçi duke folur për "GSH"

NËNDREJTORESHA E POLICISË

Aida Hajnaj, nëndrejtoresha e Policisë së Shtetit ka shkuar mëngjesin e djeshëm në lagjen "29 Nëntori" të qytetit të Fierit, ku në orët e para të mëngjesit pati një shkëmbim zjarri mes policisë dhe disa grabitësve. Nga përplasja me armë u ekzekutua njëri prej grabitësve dhe u plagos një tjetër. Pas ngjarjes, policia blindoi Fierin, ndërsa po vijon aksionin për kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarjeje.

Muçi nuk foli më shumë, pasi bashkëshorti, Minella Muçi mbylli derën duke thënë se "kemi punë". Ishte pikërisht 68-vjeçari, i cili pasi kuptoi se grabitësit po

tentonin të futeshin në shtëpinë e tij, telefonoi policinë. Gjatë aksionit për kapjen e grabitësve, këta të fundit qëlluan mbi policinë, e cila u kundërpërgjigj duke



Pallati ku jeton familja Muçi

vrarë njërin prej tyre dhe plagosur një tjetër. **BANORËT**

Ngjarja e rëndë ka tronditur dhe ka shkaktuar panik edhe tek banorët e lagjes "29 Nëntori" në Fier. Fqinjët të familjes Muçi thanë për "GSH" se janë frikësuar tejet nga ajo që ndodhi. "Fillimisht dëgjuam zhurmë. Mund të ketë qenë ora 02:20. Nuk e mbaj mend orën e saktë. Më pas dëgjuam edhe të shtëna armësh me breshëri. Mu duk sikur isha në ëndërr, por krismat i dëgjoja. Pastaj u zgjova, por nga frika nuk dola jashtë të shiko-

ja se çfarë po ndodhte. Isha vetëm, pasi burri ishte në punë", tha njëra nga fqinjët e familjes Muçi. Ndërsa, një tjetër pohoi se ngjarjen që ndodhi e mësoi nga televizioni dhe se kishte menduar se zhurma ishin fishekzjarrë. "U ngrita rreth orës 03:00, pasi dëgjoja zhurmë. Mendova mos ishin fishekzjarrë. Pastaj fjeta gjumë. Kur u ngrita sot (dje) në mëngjes mësova në televizor se çfarë kishte ndodhur. Dëgjoja se njëri nga ata hajdutët ishte vrarë. U trondita kur mora vesh se ai më i riu kishte ardhur nga Elbasani për të

VARFËRIA

"Kur u ngrita sot (dje) në mëngjes mësova në televizor se çfarë kishte ndodhur. Dëgjoja se njëri nga ata hajdutët ishte vrarë. U trondita kur mora vesh se ai më i riu kishte ardhur nga Elbasani për të grabitur këtu në Fier. Ndërsa, tjetri nga Puka. Çfarë bëhet kështu?! Njerëzve u ka hyrë litari në fyt nga varfëria, por nuk mund të mësysh tek shtëpia e tjetrit për t'i vjedhur pasurinë. Shteti duhet të marrë masa që të sigurojë rendin e qetësinë", u shpreh fqinja e familjes Muçi.

grabitur këtu në Fier. Ndërsa, tjetri nga Puka. Çfarë bëhet kështu?! Të rrezikojë tjetri jetën për mendtë e kokës. Njerëzve u ka hyrë litari në fyt nga varfëria, por nuk mund të mësysh tek shtëpia e tjetrit për t'i vjedhur pasurinë. Shteti duhet të marrë masa që të sigurojë rendin e qetësinë", u shpreh fqinja e familjes së bashkëshortëve Minella e Elsa Muçi.

KREU I SHTETIT TAKIMI

Presidenti merr pjesë në forumin "Gratë në shërbimin publik"

Meta: Më shumë kandidatë të zonjat për kryetare bashkish

"Administratë e depolitizuar dhe profesionale"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta kërkoj nga partitë politike të kandidojnë më shumë gra e vajza në zgjedhjet për kryetarë bashkie. Meta mori pjesë dje në forumin "Gratë në shërbimin publik, zbatim i të drejtave, realitete dhe sfida në vendimmarrje". Në këtë aktivitet ishin të pranishëm ish-Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Ahtifete Jahjaga; deputete, përfaqësuese të institucioneve të ndryshme, shoqëria civile etj. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë forum Presidenti Meta tha se reforma në administratën publike ka një rëndësi madhore në procesin e integritetit evropian dhe është "gur themel" në krijimin e shtetit të së drejtës, në përmirësimin e reformave strukturore dhe në garantimin e mirëqeverisjes. Gjithashtu, Presidenti i Republikës theksoi se angazhimi i grave në administratën publike është fakt i pamohueshëm emancipimi social në Shqipëri, ndërsa bëri një apel për institucionet, Parlamentin, shoqërinë civile, botën akademike, median apo sektorin privat, që t'i japin prioritet më shumë në punën e tyre respektimit të lirive dhe të drejtave të grave dhe vajzave.

"Gjithashtu, nuk mund të lë pa përmendur rëndësinë që ka promovimi i sa më shumë modeleve të suksessive të grave dhe vajzave në politikën aktive, përfshirë edhe zgjedhjet e ardhshme vendore, ku shpresoj të kemi më shumë kandidatë të zonja për të garuar si kryetare bashkish apo për të qenë në drejtimin e këshillave bashkiakë", u shpreh Meta. Sipas tij, "investimi në krijimin e një administratë publike të depolitizuar dhe profesionale duhet të jetë prioriteti numër një dhe përmirësimi i saj duhet të jetë sfida e përditshme e mirëqeverisjes". Kualifikimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i burimeve tona njerëzore, të administratës publike në mënyrë të veçantë, por edhe të sektorit privat duhet të jetë i vazhdueshëm dhe në funksion të progresit dhe sfide aktuale të globalizimit. Në finale, administrata publike duhet të ofrojë shërbime utilitare më cilësore që kënaqin pritshmëritë e qytetarëve", tha kreu i shtetit. "Nëse barazia gjinore është akoma një betejë e papërfunduar, për mijëra gra dhe vajza që akoma dhunohen në liritë dhe të drejtat e tyre, angazhimi i tyre në administratën dhe shërbimin publik në të

gjitha nivelet e saj, tashmë është një fakt i pamohueshëm emancipimi social në Shqipëri. Statistikat flasin se kemi më shumë vajza dhe gra në administratën publike dhe për këtë duhen përgjatur vetë ato, sepse në

radhë të parë është një meritë e tyre dhe kërkesat e larta që kanë për edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm", theksoi presidenti. "Më shumë sesa barazia gjinore apo diskriminimi pozitiv, sidomos në politikëbërje dhe

në politikë, duhet të vlerësojmë asetet intelektuale dhe profesionale të grave dhe vajzave në karrierë, të cilat kanë qenë në lartësinë e përgjegjësi të pozicioneve të larta publike që kanë mbajtur", nënvizoi Meta.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

PROPOZIMI

"Më shumë se sa barazia gjinore apo diskriminimi pozitiv, sidomos në politikëbërje dhe në politikë, duhet të vlerësojmë asetet intelektuale dhe profesionale të grave dhe vajzave në karrierë, të cilat kanë qenë në lartësinë e përgjegjësi të pozicioneve të larta publike që kanë mbajtur", - tha Meta.

Kufiri, ministri takon zv.koordinatorën amerikane për antiterrorizmin

Xhafaj në SHBA, shoqërohet nga Artan Didi, kërkon mbështetje nga DEA për drogën

Ministri Fatmir Xhafaj kërkoj mbështetjen e DEA-s për identifikimin e rrugëve të pastrimit të parave jashtë territorit të Shqipërisë dhe sigurimin e provave, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit për të zhvilluar hetime rreth transaksioneve financiare të këtyre grupeve kriminale, apo të personave zyrtarë të lidhur me ta. Droga dhe pastrimi i parave kanë qenë dy temat kryesore të diskutuara nga ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe zëvendës drejtori i DEA, Anthony Williams. Sa i takon luftës ndaj drogës, Xhafaj kërkoj që të rritet kapaciteti i zyrës së DEA, duke pasur një oficer të dedikuar për Shqipërinë, apo përmes intensifikimit të takimeve dhe operacioneve të përbashkëta, mes Policisë shqiptare dhe Zyrës Rajonale të DEA-s në Greqi. Ministri Xhafaj bëri një ekspozitë të arritjeve në luftën kundër kultivimit të kanabisit, duke undalur në



masat dhe rezultatet e vitit 2017, të cilat bënë të mundur nxjerrjen e vendit nga harta e vendeve që kultivojnë kanabis. Ai prezantoi disa nga masat kyçe të programuara për të garantuar këtë standard edhe gjatë vitit 2018. Në Departamentin Amerikan të Shtetit, ministri Fatmir Xhafaj u prit nga z.Matthew Palmer, i ngarkuar me detyrën e zëvendësndihmësit të Sekretarit të Shtetit për Evropën dhe Euro-Azinë. Palmer tha se qëllimi është "ta shohim Shqipërinë, të avancojë drejt BE-së". Takimi i radhës në Departamentin e Shtetit i ministrit

ARTAN DIDI

Pas një kohe të gjatë shkëputjeje, dje në krah të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj u shfaq edhe ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Artan Didi. Didi dha dorëheqjen nga detyra për shkak të fshesjes në sirtarin e policisë së urdhër arrestit belg për ish-deputetin kristiandemokrat, Mark Frroku.

të Brendshëm dhe drejtuesve kryesorë të Policisë së Shtetit, ishte me zëvendës koordinatorën për Antiterrorizmin, Alina Romanowski dhe nënshkrimi i marrëveshjes me të. Ai u fokusua në përpjekjet e Shqipërisë lidhur me parandalimin e fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe forcimin e luftës kundër terrorizmit. Romanowski vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm dhe siguroi vazhdimësinë e mbështetjes amerikane sa i takon sigurisë kufitare.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dje në forumin "Gratë në shërbimin publik, zbatim i të drejtave, realitete dhe sfida në vendimmarrje"



Noka: Deputeti i PS përvetësoi 11 mijë metra katrorë tokë, të hetohet

Partia Demokratike u shpreh dje se deputeti socialist, Alket Hyseni, ndodhet para akuzës publike se i ka vjedhur 11 mijë metra katrorë tokë në Dhërm të familjes Bua. Sipas akuzës, Hyseni ka tjetërsuar pronën nëpërmjet falsifikimit në kohën ku ai drejtonte Task Forcën për verifikimin e kthimit dhe regjistrimit të pronave në bregdetin e Jugut. "Deputeti i Partisë Socialiste, Alket Hyseni është sot i akuzuar publikisht se ka vjedhur 11 mijë metra katrorë tokë në Dhërm nga familja Bua. Çfarë e bën edhe më të rëndë grabitjen e pronës nga familja Bua tek Alket Hyseni dhe më pas tek mik i kryeministrit është fakti se ai e ka kryer transaksionin në kohën kur Edi Rama e kishte emëruar kryetar të Task Forcës për verifikimin e kthimit dhe regjistrimit të pronave në bregdetin e Jugut", tha Noka. Partia Demokratike nëpërmjet deputetit Flamur Noka i ka kërkuar prokurorisë të veprojë. Sipas deputetit Noka, ky është një rast për prokurorinë të tregojë se nuk është selektive dhe pjesë e axhendës politike të palës që është në pushtet.

"Open Data", 12 propozime, Brahaj: Dhurimet për partitë të bëhen në banka

Komisioni për Reformën Zgjedhore zhvilloi këtë të premte seanca dëgjimore me organizatë të shoqërisë civile, që operojnë në fushën e zgjedhjeve. Në fillim të mbledhjes, bashkëkryetari i Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, z. Oerd Bylyk-bashi vlerësoi praninë e përfaqësuesve të OSBE-ODIHR duke u shprehur se kjo është një tregues shumë i qartë i gatishmërisë për të asistuar në mënyrë intensive në këtë fazë të rëndësishme, por edhe në vazhdim. Deputetët e Komisionit të Posaçëm dëgjuan 12 propozime të "Open Data Albania", prezantuar nga Aranita Brahaj. Në kulmin e diskutimeve për financime lobbime, Brahaj kërkoj që të ndryshojnë rregullat ligjore për donacionet. "Dhurimet të bëhen vetëm përmes llogarive bankare, fushata të mëhershme sikurse edhe kjo e fundit, dhurimet në cash janë deri në 50% të totalit të fondeve jopublike të siguruar për fushatën. Duhet informim në kohë reale mbi donacionet monetare të fushatës, edhe përpara datës së votimit. Duhet rregullim më efikas i rasteve të parashikuara si konflikt interesi për donatorët", u shpreh Brahaj. Sipas saj, "përvec parashikimit për kontrata dhe fonde publike, të parashikohet si konflikt interesi edhe rasti i përfitimit me nga programe të subvencionit publik, kreditimit të garantuar me fonde publike, përfuttes në privatizime të aseteve publike, përfuttes nga legalizimet, përfuttes nga programe publike në dobi të biznesit".



"GRATË NË SHËRMBIMI ZBATIMI I TË DREJT LITETE DHE SFIDA NË VE"

DROGA

Zoti Rama argumentoi se vendi i tij ka bërë "progres mbresëlënës" në uljen e kultivimit të kanabisit dhe numrit të vrasjeve. Ai shtoi se problemet e vendit me heroinën dhe kokainën nuk janë "tipike" krahasuar me vendet të tjera europiane. Ai pranoi se lufta kundër korrupsionit është "një betejë e përhershme", por një fushatë kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë ka sjellë tashmë rezultatet e para.



Afera e financimit rus, Ulsi Manja: Lulzim Basha të thirret në prokurori

Sekretari i Asamblesë Kombëtare të PS-së, deputeti Ulsi Manja kërkoi dje që kreu i PD-së, Lulzim Basha të thirret në prokurori. "Koha e Lulzim Bashës për të bërë transparencë në lidhje me aferën e parave ruse të lobimit dhe mashtrimin në deklaratat e KQZ ka kaluar. Tanimë është e qartë për të gjithë se Lulzim Basha asnjëherë nuk do të shkojë me dëshirën e tij në prokurori për të qartësuar akuzat e rënda që peshojnë mbi të dhe mbi Partinë Demokratike", u shpreh Manja në një dalje për mediat. Sipas tij, "provat janë të qarta dhe të pakundërshtueshme. Ekzistojnë së paku pesë deklaratat që provojnë se fushata e fundit zgjedhore e Partisë Demokratike u financua me para me prejardhje ruse. Me vullnetin e tij Basha nuk pranon të thotë asgjë në lidhje me origjinën e dyshimtë të këtyre parave dhe as me lidhjet e tij të errëta me Kremlin. Përdërisa ai nuk ka ndërmend të bëjë transparencë, është prokuroria ajo që duhet të kryejë detyrën e saj, duke i shkuar këtij skandali deri në fund. Me veprimet e tij të papërgjegjshme, Lulzim Basha ka kryer jo një, as dy, por plot gjashtë vepra penale", argumentoi Manja. Sipas tij, "Basha duhet të hetohet për fshehjen e të ardhurave, një veprë penale e parashikuar nga neni 180/3 e Kodit Penal, një veprë e dënueshme deri në tri vite heqje lirie. Basha duhet të hetohet për falsifikimin e dokumenteve zyrtare, një veprë penale e parashikuar nga neni 186/3 e Kodit Penal dhe e dënueshme deri në shtatë vite heqje lirie. Një njeri që pretendon të jetë kryeministri i ardhshëm i këtij vendi, nuk mund të lejohet që të falsifikojë dokumentet zyrtare e të shkelë ligjin sa herë që ti leverdisë. Lulzim Basha duhet të përgjigjet për të gjitha zullumet e tij. Ai nuk do ta bëjë kurrë këtë me dëshirë, ndaj është koha e drejtësisë që të bëjë detyrën e saj!", tha Manja.

Kryeministri për "Financial Times": Të shpërblehemi për atë që bëmë

Rama: Fillim i shpejtë i bisedimeve për anëtarësim në BE, proces i drejtë

"Raportet me Greqinë, rreth verës do zgjidhim gjithçka"

Michael Peel

Kryeministri Edi Rama kërkoi dje fillimin e shpejtë të bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. "Ajo që duam ne tani është thjeshtë të shpërblehemi për atë që bëmë dhe që procesi të jetë i ndershëm dhe i parashikueshëm", deklaroi kryeministri Edi Rama në një intervistë për gazetën "Financial Times". Duke kërkuar fillimin e bisedimeve për t'u anëtarësuar në BE si pjesë e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor për të forcur sigurinë europiane, Rama shprehet se "do të ishte shumë e çuditshme nëse Shqipëria nuk do të fillonte menjëherë negociatat, pasi ka bërë saktësisht çdo gjë që i ishte kërkuar të bëjë". Kryeministri theksoi: "17 gjykatës dhe prokurorë kishin zgjedhur të vetëlargoheshin, në vend që t'i nënshtroheshin një rivlerësimi lidhur me punën në të kaluarën dhe burimin e pasurisë së tyre".

SHKRIMI I PLOTË I "FINANCIAL TIMES":

Kryeministri i Shqipërisë tha se vendi kishte punuar fort kundër problemeve të drogës dhe korrupsionit në drejtësi. Kryeministri shqiptar ka kërkuar fillimin e bisedimeve për t'u anëtarësuar në BE si pjesë e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor për të forcur sigurinë europiane. Edi Rama tha se do të ishte "çmenduri" për BE-në, nëse do të dëshronte të përfshinte një rajon në qendër të rrugëve të migracionit dhe të cilit, ia ka vënë syrin Rusia si një çmim strategjik. Kryeministri argumentoi se Tirana kishte punuar shumë kundër problemeve të drogës dhe korrupsionit në sistemin e drejtësisë, duke u bërë një kandidat serioz në përbushjen e ambicieve të Brukselit për vendet e Ballkanit Perëndimor për të marrë miratimin deri në 2015-ën.

"Do të ishte shumë e çuditshme nëse Shqipëria nuk do të fillonte menjëherë negociatat, pasi ka bërë saktësisht çdo gjë që i ishte kërkuar të bëjë", tha artisti tashmë në krye të qeverisë në një intervistë, duke vënë në dukje se Serbia dhe Mali i Zi tashmë i kanë filluar bisedimet e anëtarësimit.



Kryeministri Edi Rama

GREQIA

Kryeministri u shpreh se shpresonte lidhur me një marrëveshje të afërt me Greqinë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi ujërat territoriale në detin Jon dhe kompensimin e pronave të camëve, një pakicë shqiptare e dëbuar nga veriperëndimi i Greqisë gjatë Luftës së II Botërore. "Rreth verës, shpresoj që do të zgjidhim gjithçka", tha ai duke shtuar se Shqipëria dhe Greqia janë teknikisht ende në luftë falë një trashëgimie tjetër të Luftës së II Botërore.

"Ajo që duam ne tani është thjeshtë të shpërblehemi për atë që bëmë dhe që procesi të jetë i ndershëm dhe i parashikueshëm". Z. Rama foli për gazetën "Financial Times" gjatë një vizite në Bruksel përpara samitit të BE-së këtë javë. Komentet e tij pasqyrojnë një mërzitje në Tiranë për shkak se Shqipëria nuk është lejuar akoma të fillojë bisedimet, pavarësisht nga progresi i bërë me reformat ekonomike dhe politike. Aleksandar Vučić, presidenti i fortë serb, është përfaqësuar nga BE-ja pasi ai deklaroi se bashkimi me bllokun e 28 vendeve është qëllimi i tij politik kryesor, megjithëse ai është ndeshur me kritikën në vendin e tij nga disa vëzhgues të huaj se gjoja ka shtyrë lirinë e medias. Z.Rama i bëri thirrje Komisionit Evropian të rekomandojë hapjen e negociatave të anëtarësimit, me qëllim që udhëheqësit e vendeve të BE-së të mund ta miratojnë atë gjatë samitit të qershorit. Ai vuri në dukje rëndësinë e Shqipërisë dhe të vendeve fqinje në frenimin e vërshimit të emigrantëve në bllok, duke shtuar se interesi dhe influenca e Rusisë në Ballkanin

Perëndimor, ndonjëherë kjo është e zmadhuar, ishte reale. "Moska asnjëherë nuk ka hequr dorë nga vlerësimi i rëndësishëm gjeografikë të rajonit, gjë që nuk shihet nga shumë në BE, me përjashtim të kancelares gjermane Angela Merkel", tha shtatlartari Rama, i cili ka qenë pjesëtar i ekipit të basketbollit të Shqipërisë. "Është çmenduri të mendosh se Ballkani Perëndimor mund të lihet mënjë, le më pastaj jashtë Europës". Tirana dëshiron shumë të përfillojë nga shenjat e vrullit të përtërirë të zgjerimit të BE-së, pasi muajin e kaluar Komisioni publikoi strategjinë e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor. Dokumenti sugjerohe që Shqipëria dhe pesë vende të ish-Jugosllavisë mund të hyjnë në BE brenda tetë vitesh, por vetëm në qoftë se ato plotësojnë kushtet e repta si zgjidhja e konflikteve të dalueshme dypalëshe dhe korrupsionit. Disa vende anëtare të BE-së mbeten skeptike lidhur me perspektivën e anëtarësimit të grupit të gjashtë vendeve në kushtet e "lodhjes në të gjerë të anëtarësimit", që pasoi krizën financiare të

vitet 2008, problemet e borxhit të eurozonës dhe votimin për daljen e Britanisë së Madhe nga Unioni. Liderët e bllokut do të takohen me homologët e tyre të Ballkanit Perëndimor në një samit të veçantë në Sofje në muajin maj. Zoti Rama argumentoi se vendi i tij ka bërë "progres mbresëlënës" në uljen e kultivimit të kanabisit dhe numrit të vrasjeve. Ai shtoi se problemet e vendit me heroinën dhe kokainën nuk janë "tipike" krahasuar me vendet të tjera europiane. Ai pranoi se lufta kundër korrupsionit është "një betejë e përhershme", por një fushatë kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë ka sjellë tashmë rezultatet e para. Ai tha se 17 gjykatës dhe prokurorë kishin zgjedhur të vetëlargoheshin, në vend që t'i nënshtroheshin një rivlerësimi lidhur me punën në të kaluarën dhe burimin e pasurisë së tyre. Kryeministri u shpreh se shpresonte lidhur me një marrëveshje të afërt me Greqinë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi ujërat territoriale në detin Jon dhe kompensimin e pronave të camëve, një pakicë shqiptare e dëbuar nga veriperëndimi i Greqisë gjatë Luftës së II Botërore. "Rreth verës, shpresoj që do të zgjidhim gjithçka", tha ai duke shtuar se Shqipëria dhe Greqia janë teknikisht ende në luftë falë një trashëgimie tjetër të Luftës së II Botërore. "Pra, 70 vjet historiku nuk do të jenë më pengesë në rrugën drejt së ardhmes", u shpreh ai.

PERMBYTJET KËRKESA

Kreu i PD inspekton zonat e përmbytura në Shkodër: Prokuroria të nisë hetimet

Basha, Ramës: Mosshpallja e emergjencës, vepër kriminale

"Po shmangin dëmshpërblimin për të dëmtuarit"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha inspektoi dje zonat e përmbytura në Shkodër nga ku i bëri thirrje kryeministrit Edi Rama që të shpallë menjëherë gjendjen e emergjencës pasi sipas tij situatat është tejet e vështirë. Z. Basha foli për situatën me të cilën po përballen qarku i Shkodrës, teksa akuzoi kryeministrin e vendit që po bën një shkelje penale, ndaj kërkoj të vihet para përgjegjësive ligjore për mosshpalljen e emergjencës. Ndajësia e parë e kryedemokratit ishte në Dajç, ku pa nga afër situatën. Basha tha se situata po shkon drejt përkeqësimit dhe se mosshpallja e emergjencës është përgjegjësi ligjore dhe vepër kriminale. Në këtë gjendje ku ndodheni, ju inkurajoj dhe ju jap mbështetjen time dhe të Partisë Demokratike, banorët këtu në Shkodër e dinë fare mirë që edhe një festë po të zgjasë 15 ditë do të na lodhte, imagjino një përmbytje. Falënderoj organizatat bamirëse, dhe të ndihmës së huaj që japin ndihmën modeste. Mungesa e kryeministrit dhe vartësve të tij fajsojnë përgjegjësini e tyre. I akuzoj për braktisjen e Shkodrës, dhe mos prezantimin e situatës në gjendjen reale në të cilën ajo është. Në aspektin afatgjatë dëmet janë shumë të mëdha, dëm në infrastrukturë. Do të përgatisim një raport për dëmet dhe do shohim të japim fonde me aq mundësi sa ka PD, të krijojmë fonde për rikuperim sadopak të vogël të situatës. Do ngremë zërin për shpalljen e gjendjes së emergjencës", u shpreh Lulzim Basha. Sipas tij ka dy arsye që qeveria nuk shpall gjendjen e emergjencës. "Mos shpallja e emergjencës për përgjegjësi ligjore dhe penale. Çdo pasojë negative është i drejtoj sot një apel të drejtpërdrejtë për të shpallur emergjencën. Prokuroria të nisë hetimet për çdo neglizhencë. Mos shpallja e emergjencës nga Rama ka dy arsye, e para që është kriminale sa është edhe absurde



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Shkodër

AKUZA

"Mosshpallja e emergjencës nga Rama ka dy arsye, e para që është kriminale sa është edhe absurde dhe e dyta për të shmangur dëmshpërblimet për familjet e dëmtuara kur ata që janë bashkë përgjegjës", -theksoi kreu i PD-së.

"Zgjidhja e situatës, taksa të ulëta"

Tabaku: Taksat janë rritur me mbi 2 mld USD

Përmes një statusi në "Facebook", deputetja e PD, Jorida Tabaku thotë se sipas pyetësorit të Dhomës Amerikane të Tregtisë, Shqipëria ka rënë me 2.15 pikë dhe se taksat e larta janë pengesa kryesore e bizneseve në vend. "Problemi është taksa, problemi është qeveria! Një tjetër zë i rëndësishëm dhe me peshe i është bashkuar sot shtetësimi të bizneseve vendase dhe opozitës, Dhoma Amerikane e Tregtisë në vlerësimin e saj vjetor nënvizon se problemi në vend janë taksat. Pyetësori, i bërë publik prej saj, nënvizon se Shqipëria ka rënë me 2.15 pikë dhe se taksat e larta janë pengesa kryesore e bizneseve në vend shoqëruar me burokracinë e lartë. Që nga paketa fiskale 2014 biznesi vendas është kthyer në një kavie eksperimentale e qeverisë. Taksat në vend janë rritur me mbi 2 mld USD kumu-



Rritja

Tabaku shprehet se taksat në vend janë rritur me mbi 2 mld USD kumulativisht dhe bizneset vazhdojnë të mbyllen, ndërsa sipas saj shpëtimi është taksa e sheshtë dhe një qeverisje e djathtë.

lativisht. Bizneset vendase vazhdojnë të mbyllen dita ditës ndërkohë që tërheqja e investimeve të huaja është minimale. Një situatë e tillë paralajmëron një krizë në rritjen ekonomike të vendit dhe njëkohësisht një krizë në konsum. Taksat e vendosura nga qeveria po thellojnë pabarazinë dhe po varfërojnë përditë shqiptarët", shprehet

Tabaku. Sipas saj shpëtimi i vetëm është taksa e sheshtë dhe një qeverisje e djathtë, me taksa të ulëta, deregullim të lartë dhe incentiva fiskale në shërbim të sipërmarrjes. Dhoma Amerikane e Tregtisë nëvojti shumë prej bizneseve shqiptare evidencat qartë se problemi sot në vend është qeveria!

dhe e dyta për të shmangur dëmshpërblimet për familjet e dëmtuara kur ata që janë bashkë përgjegjës", theksoi kreu i PD-së. Nisur nga situata problematike në këtë qark, z. Basha i kërkoj organit të akuzës që të nisë hetimet për mosshpalljen e gjendjes së emergjencës. "Mungesa e

kryeministrit dhe paraqitje fotozhenike e vartësës së tij ministre bashke me heshtjen e tyre tregojnë qartë sjelljen e tyre. I fajsoj për braktisjen e shkollës dhe mosmenaxhimin e kësaj situatë kritike. I kërkoj prokurorisë që të nis hetimet kryesisht për këtë heshtje dhe veprim krimi-

nal", u shpreh kreu i PD-së. Sipas Bashës shkak i përmbytjeve nuk janë reshjet e shiut, por shkakimet në kasakadën e Drinit. Më pas kreu i demokratëve pa nga afër situatën në njësitë administrative të Bërdicës e Dajçit, të cilat prej ditësh ndodhen nën pushtetin e ujit.



Pamjet e publikuara nga kreu i PD-së, i situatës së përmbytjeve në Shkodër

Përmbytjet, Bushati dhe Xhaçka: Shteti, në krye të detyrës

Ministrit Ditmir Bushati dhe Olta Xhaçka ndodhen në Shkodër, ku kanë inspektuar zonat e përmbytura. Ata ndaluan në fshatin Dajç ku u takuan me banorët. "Shteti në krye të detyrës. Po ndjekim situatën dhe kemi marrë masa për jetën e njerëzve dhe gjësë së gjallë", tha Bushati. Kurse sipas ministres së mbrojtjes nevojitet koordinim me qeverisjen lokale. "Forcat e Armatosura janë prezente nga dita e parë. Nevojitet koordinim institucional me pushtetin lokal. Pritet të mbërrijnë 300 tonë koncentrat për bagëtinë", theksoi znj. Xhaçka. I pranishëm dhe deputeti demokrat Romeo Gurakuqi, cili vlerësoi punën e ushtrisë dhe policisë. Ministria e Mbrojtjes, në një reagim të saj, u shpreh se "në Shkodër vazhdojmë të jemi në këmbë 24 orë në 24, që prej minutës së parë, kudo ku uji ka paralizuar jetën e njerëzve, në Obot, Dajç, Ana e Malit, Trush, Livadhë, Velipojë apo Bushat". "Kushdo që thotë se, ushtria nuk e njeht terrenin mirë, me siguri ka shkuar vetëm në ato zona ku e gërren meraku për militanët. Për ne, banorët e Shkodrës janë qytetarë të Shqipërisë! Ndaj sot e përherë, përtej llafave e sajësive përçarëse politike e mediatike, do të trajtohen njësoj, për ti bërë ballë të gjithë bashkë, tërbimit të natyrës, që na ka sjellë këto ditë të vështira", tha Xhaçka. "I bëjmë thirrje pushtetit vendor dhe administratorëve lokalë, të lënë llafet e propagandën boshë të politikës ndarëse të ditës, dhe të marrin masat për koordinimin e shpërndarjes, në bazë të nevojave, pa dallim, për të gjithë banorët në zonat e rrethuara nga uji", tha Xhaçka.

Përmbytjet, Vasili: Shpallja e emergjencës, një orë e më parë

Lëvizja Socialiste për Integrim i bëri dje apel qeverisë që të shpallë sa më parë gjendjen e emergjencës në zonat e përmbytura në Shkodër. Në një dalje për mediat, kryetari i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili i tha se çdo minutë e kaluar, jo vetëm rëndon situatën atje, por e ngarkon me përgjegjësi penale dhe të pakapërcyeshme qeverisjen dhe qeveritarët, kryeministrin dhe ministrat e tij, të cilët jo vetëm janë inekzistentë, por nuk predispozojnë asnjë instrument ligjor dhe marrje përgjegjësish përpara qytetarëve, të cilët po dëmtohen dhe po shkatërrohen ekonomikisht. Kjo nuk pret më. Duhet reaguar tani. Çdo minutë që kalon është faj i madh publik, dhe pse jo një faj i pashlyeshëm penal", u shpreh z. Vasili.



Valentina Madani

Demokratët kanë mbyllur zyrtarisht procesin e propozimeve të ardhura nga degët për ndryshimet në statutin e PD-së, të cilat pritet të miratohen në Kuvendin Kombëtar më 28 dhe 29 prill. Në 8 mars në mbledhjen e kryesisë, kur u vendos thirrja e Kuvendit Kombëtar dhe nisja e procesit të ristrukturimit të Partisë Demokratike, kryetari Lulzim Basha mandatoi një grup punë që do të vendoste kontakte dhe do të merrte çdo platformë apo propozim për ndryshime në statut. 22 marsi ishte fiksuar si data kur ky grup që kryesohet nga nënkryetari Edi Paloka dhe në përbërje ka Edmond Spahon, sekretarin e përgjithshëm, Arben Ristani; sekretarët Enno Bozdo dhe Fatbardh Kadilli dhe anëtarin e kryesisë Gent Malko, të mbyllte punën kryesore të tij. Deri në 22 mars grupi i punës priti propozimet nga çdo anëtar për ndryshimin e statutit të PD-së. Kurse më 25 mars krerët e degëve duhet të sjellin listën e delegatëve për Kuvendin Kombëtar, që do të mbahet në datat 28-29 prill. "GSH" ka mundur të sigurojë disa nga propozimet e sjella në qendër nga degët e PD-së, ku kryesisht në fokus është vendim-marrja e anëtarësisë. Shqyrtimi i propozimeve për ndryshimet në statutin e PD-së do të bëhet nga departamenti i çështjeve ligjore të partisë, konkretisht nga dy juristët demokratë, Gazmend Bardhi dhe Ini Kaso. Një instrument që vihet re pothuajse në çdo propozim është që kandidatët për kryetar bashkë dhe për deputet t'i nënshtrohen më parë votës së anëtarëve të Partisë Demokratike dhe minimalisht ata duhet të jenë 10 vite si anëtarë të PD-së. Ky propozim është përmendur herë pa here nga vetë kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i cili pas listës së zgjedhjeve të 2017-ës, deklaroi se ajo do ishte e fundit që mbante firmën e tij, pasi nga ai moment do ishte anëtarësia që do vendoste për përfaqësuesit e tyre. Një tjetër propozim është zvogëlimi i numrit të anëtarëve të kryesisë së PD-së dhe Këshillit Kombëtar. Nga rreth 7500 anëtarë që ka Kuvendi Kombëtar, pritet që me ndryshimet e reja ai të tkurret në 1500, po ashtu tkurrje do të ketë edhe Këshilli Kombëtar, nga 275 anëtarë në 140. Jashtë ristrukturimit nuk do të mbetet edhe kryesia e Partisë Demokratike, nga 56 anëtarë që ka aktualisht, ajo do të fokusohet në vetëm 15, të cilët do jenë figurat kryesore të kupolës drejtuese. Kuvendi kombëtar do të vendosë

Degët e PD dorëzojnë propozimet, shqyrtimi në dorë të Kasos dhe Bardhit

Propozimet, kandidatët për deputetë të jenë minimalisht 10 vite anëtarë të PD

Kërkohej zvogëlimi i kryesisë dhe Këshillit Kombëtar



Selia e PD-së

SHQYRTIMI

Shqyrtimi i propozimeve për ndryshimet në statutin e PD-së do të bëhet nga departamenti i çështjeve ligjore të partisë, konkretisht nga dy juristët demokratë, Gazmend Bardhi dhe Ini Kaso. Më 25 mars krerët e degëve duhet të sjellin listën e delegatëve për kuvendin kombëtar, që do të mbahet në datat 28-29 prill.

NDRYSHIMET NË STATUTIN E PD, DISA NGA PROPOZIMET E DEGËVE

- Caktimi në territor të njerëzve me peshtë elektorale. Konkretisht njerëzit me peshtë të drejtojnë territore elektorale në të gjitha nivelet.
- Kryesia aktuale nga 50 anëtarë, të bëhet më e vogël me rreth 20 anëtarë.
- Këshilli kombëtar nga 275 anëtarë që është aktualisht, të jetë me 150 anëtarë.
- Duhet të bëhet ndarja e roleve, ekzekutivi i partisë mban partinë, kurse deputetët merren me çështjet e parlamentit.
- Deputetët të mos jenë të panjohur në zonat ku zgjidhen, por të jenë anëtarë minimalisht prej 10 vitesh në Partinë Demokratike.
- Marrja e mendimit të anëtarësisë për kandidaturat për deputetë dhe kryetarë bashkish.
- Zgjedhja e kryetarëve të degëve dhe grup-seksioneve të bëhet përmes parimit "një antëtar, një votë".
- Krijimi i trupave ku të gjithë mund të marrin pjesë e të flasin.

NJOFTIMI



Oborri Mbretëror përplaset me PLL: Nuk njohim ish-kryetarin Gjana

Oborri Mbretëror shqiptar përmes një njoftimi të shpërndarë në faqen zyrtare në "Facebook" informoi dje se ka shkëputur çdo bashkëpunim apo komunikim me kreun e Partisë Lëvizja e Legalitetit, pasi Sulejman Gjana nuk përfaqëson vlerat, traditën dhe kulturën mbretërore. Në njoftimin e shpërndarë, "Oborri" thekson se bashkëpunimi nuk mund të vijojë me ish-kreun e kësaj partie, duke mos lejuar kështu që të përdoret imazhi i familjes mbretërore për interesa personale. Në fund të njoftimit, Oborri Mbretëror paralajmëron se Sulejman Gjana nuk përfaqëson më familjen mbretërore në asnjë eventim apo veprim.

Selami: Basha i dështuar, Berisha nuk është zgjidhje

Ish-kryetari dhe një prej themeluesve të Partisë Demokratike, Eduard Selami reason më në fund për zhvillimet në PD. Përmes një statusi në faqen e tij në "Twitter", Selami akuzon Bashën si shkatërrimtar të partisë, ndërkohë që sipas tij as Berisha nuk është zgjidhje. "Basha është i dështuar, Berisha nuk është zgjidhja, PD duhet reformuar mbi vlera demokratike", shkruan Selami. Ish-deputeti i kësaj partie nuk kish-te folur që prej shtatorit të vitit të kaluar, pasi Basha e la jashtë listave të kandidatëve. "Pavarësisht se kish-te mangësi e manipulime dhe pavarësisht se Basha nuk është prononuar ende për këtë fakt për turpin e tij, unë prapë i uroj suksese dhe shpresoj që PD të fitojë zgjedhjet e radhës. Unë i qëndroj asaj që nuk bojkotohet partia. Kritikët nuk i shërbyen as vetes dhe as Partisë Demokratike. Kam thënë që fushata ishte e pabarabartë dhe e padrejtë, por unë sërish e njoh legjitimitetin e zotit Basha, sepse mendoj se është në të mirë të forcës sime politike". - u shpreh Selami në emisionin "Top Story" në muajin shtator.



për këto ndryshime dhe do të mblidhet më 28-29 prill, ndërsa parashikohet që e gjithë faza ristrukturimit të mbyllet brenda muajt qershor. Demokratët përgjatë 4 muajve zhvilluan analizën në të gjitha degët pas humbjes së

zgjedhjeve. Pjesë e procesit të analizës dhe konsulencës ka qenë edhe verifikimi i anëtarësisë në çdo njësi organizative të PD-së. Verifikimi është kryer paralelisht me analizën dhe i gjithë procesi është koordinuar nga sekre-

Mustafaj: Berisha bashkon demokratët, Basha bën lidhshirin

Ish-ministri demokrat, Besnik Mustafaj foli dje për gjendjen aktuale të PD dhe tha se nuk e sheh si zgjidhje rikthimin e Sali Berishës në krye të partisë. "I vetmi personalitet që mund t'i bashkojë të gjithë brenda PD është Berisha, këtë e thonë edhe të tjerët. Nuk mendoj se kjo është zgjidhja, por besoj se Berisha e ka bërë të qartë këtë, duke thënë sidomos pas zgjedhjeve të 2017-ës, që pas humbjes së thellë të PD, dhe ai në disa dalje ka theksuar se ai nuk kthehet më. Besoj se nuk është zgjidhja tek rikthimi, se ai e ka bërë rrugën e tij në politikë dhe se ai vetë nuk e beson një gjë të tillë. Shumë e mendojnë se koha e drejtit të PD nga Berisha është një kapitull i mbyllur. Kjo thirrje që drejtohet te Berisha është shprehje e dëshpërimit të madh që zotëron te një pjesë e madhe e demokratëve. Sfidat që ka PD është kapërcimi i këtij dëshpërimi", tha ai në studion e "News 24". "Mua - shtoi ai - nuk më rezultojn se Berisha është prapa Bashës, prej disa kohësh jo vetëm tani. Basha po bën lidhshirin e tij dhe është përgjegjës 100% i gabimeve të tij. Unë besoj se kontradikta që është tani në sjelljen politike të demokratëve, qëndron në faktin se edhe kritikët e Bashës nuk po shkojnë më tej se kaq", tha Mustafaj.

tari organizativ i partisë, z.Enno Bozdo. Ky verifikim ka ndodhur në pjesën dërmuese të degëve dhe pritet të mbyllet brenda dy javësh. Një porosi specifike e z.Bashas në mbledhjen e kryesisë ishte që drejtuesit në bazë nuk duhet

të lënë jashtë vëmendjes takimet me qytetarët. PD synon që të gjithë procesin e ristrukturimit të saj në bazë dhe në degë ta përmbyllë deri në fund të qershorit, për t'u bërë gatë për zgjedhjet vendore të vitit 2019.

Nevoja për punësim, ekspertët gati draftin e ri me propozime

Qeveria, strategji të re për uljen e papunësisë

Anastas Angjeli: Në fokus, punësimi i të rinjve

Ornela Manjani

Qeveria po përgatit një draft të ri për punësimin, i cili do të ketë në fokus të rinjtë. Draft i ri për punësimin, për evidentimin e problemeve të tregut dhe gjetjen e zgjidhjeve për krijimin e vendeve të punës po përgatitet nga ekspertët, të cilët po punojnë për strategjinë e re, që do t'i shërbejë qeverisë për uljen e papunësisë për periudhën 2018-2022. Lajmin e bën të ditur Anastas Angjeli, anëtar i Komisionit parlamentar të Ekonomisë dhe drejtes i grupit të punës, që po harton draftin. Pjesë e grupit të punës janë edhe deputetë të tjerë, si dhe ekspertë dhe akademikë. "Qeveria ka ndeshmëri të lartë për punësimin dhe kërkon ta zgjidhë këtë çështje në afatmesëm dhe afatgjatë. Kryeministri ka ngarkuar një grup pune që po përgatit një dokument për strategjinë e re të punësimit. Dokumenti fokusohet në disa drejtime, për prioritetet e strategjisë në afatmesëm dhe rekomandime për hapjen e vendeve të reja të punës nëpërmjet instrumenteve të politikave të zhvillimit, por edhe instrumenteve financiare", ka shpjeguar Angjeli.

STRATEGJIA

Në katër vitet e ardhshme qeveria do të orientojë të rinjtë drejt arsimit profesional dhe sidomos në sektorin e teknologjisë. Anastas Angjeli, deputet i PS-së dhe njëherësh hartues i draftit të ri, ka shpjeguar se ndryshimet synojnë të nxisin punësimin e të rinjve, të rrishtur rolin e institucioneve të punësimit, të bashkohen në një të gjitha fondet e punësimit dhe t'i jepet me shumë kompetencë vendorëve. Angjeli tha se në draft do të paraqitet edhe një analizë e qartë e kostove të një vendi pune. Qeveria shqiptare ka nisur hartimin e një draftit ligji të ri për të ulur papunësinë në katër vitet e ardhshme. Në qendër të vëmendjes do të jetë orientimi i të rinjve drejt teknologjisë, si mundësia më e mirë për t'u përfshirë në konkurrencën e tregut të punës në Europë, por dhe të zhvillimeve në Shqipëri. "Pa dyshim që në fokus janë punësimi i të rinjve, i cili është një problem edhe për vendin tonë. Grumbullojmë të gjithë informacionin e nevojshëm të fondeve të ndryshme, të fondeve që jepen për investime në vendin tonë, të investimeve që bën sektori privat dhe ai shtetëror. Edukimi, shkollimi, kualifikimi, dhe riaftësimi profesional drejt vendeve të punës duke pasur një angazhim më të madh të bizne-



Anastas Angjeli, anëtar i Komisionit parlamentar të Ekonomisë

sit në vendet e punës"-tha ish-ministri i Financave. Dokumenti do t'i nënshtrohet diskutimit publik me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Takimi i parë u

bë me gazetarët e ekonomisë, të cilët dhanë opinionet e tyre për përmirësimin e draftit. Të tjera takime dhe tryeza diskutimi janë parashikuar në disa rrethe të Shqipërisë,

me përfaqësues të biznesit, pushtetit vendor dhe aktorë të tjerë. "Do të bëjmë një analizë të kostove-përfitim. Pra, sa lekë kushton një vend pune në Shqipëri. Gjithash-

PAPUNËSIA NË VEND

Niveli i papunësisë në Shqipëri është ulur vitet e fundit, megjithëse ky mbetet një problem shumë i madh për vendin. Pasi, rritja ekonomike relativisht e lartë kundrejt rajonit, në rreth 3.7% nuk reflektohet në krijimin e vendeve të reja të punës, shqetësim i ngritur edhe nga misioni i fundit i FMN-së, pak ditë më parë. Të dhënat e Institutit të Statistikave tregojnë se niveli i papunësisë për vitin 2017 shënoi 13.7% nga 15.3% që ishte një vit më parë.

tu, do të propozojmë një rishtrukturim të institucioneve për punësimin, me qëllim që të ulet diferenca mes rritjes ekonomike dhe punësimit",-ka shpjeguar Angjeli.

Rritja e pragut, Shoqata e Biznesit të Vogël

Protesta deri në grevë urie kundër TVSH-së

Shoqata e Biznesit të Vogël ka paralajmëruar se do të nisë protestat masive, duke u përshkallëzuar deri në grevë urie në rast se qeveria nuk tërheq mbrapsht vendimin për të përfshirë në skemën e TVSH-së bizneset që kalojnë xhiron vjetore prej 2 milionë lekësh. Sipas kryetarit të shoqatës, Alberta Nasta, përfshirja e biznesit të vogël në skemën e TVSH-së shënon fundin e tyre. Ai tha për Monitor se shoqata, bazuar në sondazhet dhe analizat e veta parashikon se numri i bizneseve të mbyllura në gjashtë mujorin e parë do të shkojë deri në 50 mijë. Nasta shton për Monitor se vendosja e pragut të TVSH-së do të shtojë më shumë korrupsionin dhe evazionin, si dhe do të rrisë selektivitetin. Shoqata e Biznesit të Vogël dhe të Mesëm po organizohet edhe nëpër rrethe për të nisur protestat në datën 2 prill. Fillimisht bizneset e vogla do të mbyllin çepinat e dyqaneve dhe nuk do të operojnë për disa orë. Nasta thotë se do përdorin çdo



PROTESTA

Shoqata e Biznesit të Vogël ka rreth 22 mijë anëtarë të regjistruar në të gjithë vendin, të cilët po organizohen për të kundërshtuar vendimin e qeverisë.

formë demokratike, deri në grevë urie, për të kthyer mbrapsht vendimin e qeverisë. Vendosja e TVSH-së për biznesin e vogël rrit shpenzimet e njësive ekonomike, por edhe çmimet e produkteve dhe shërbimeve. Sipas kryetarit të Shoqatës së Biznesit të Vogël rritja e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve që ata tregtojnë do të përkthehet në falimentim të menjëhershëm, duke qenë se fuqia blerëse është e ulët.

Tatimet parashikojnë që fillimisht në skemë do të përfshihen rreth 11,300 biznese të vogla, por sipas përfaqësuesve të shoqatës në rast se tatimet do të monitorojnë bizneset të gjithë përfshihen në skemë dhe e kalojnë pragun prej 2 milionë lekësh, i cili sipas tyre është lehtësisht i kapërcyeshëm prej bizneseve të vogla. Biznesi i vogël ka një marzh të ulët fitimi, nga 2 deri në 10 për qind e xhiros.

ISHTI

Masa edhe për njësitë e OSHEE

Inspektorati Shtetëror i Teknik dhe Industrial ka ndëshkuar me masa administrative 9 subjekte për muajin shkurt, duke fatuar një total prej 5.9 milionë lekë në vlerë gjobash. Gjobat variojnë nga 100 mijë deri në 1.5 milionë lekë dhe janë të përqendruara kryesisht në subjekte që operojnë në rrethe. Në krahasim me muajin janar, kur u ndëshkuan 5 subjekte, vlera e gjobave është 1.75 milionë lekë më e lartë. Ajo që bie në sy është ndëshkimi edhe i njësitë të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Njësia Elektrike në Kukës, Nënstacioni në Bajram Curri dhe Agjencia Elektrike në Tropojë janë gjobitur me nga 100 mijë lekë për mos respektim të rregullores me pasojë aksident të rëndë. Ndërkohë, gjobat më të larta i takojnë tre subjekteve që tregtonin karburant jashtë normave të lejuara. Ndër shkeljet e tjera të evidentuara nga ISHTI gjatë muajit Shkurt ishin edhe mungesat e dokumentacionit dhe përdorimi i rezervuarit pa targën.



Financat, fond 500 mijë USD për konsulencë

Një fond prej 59.9 milionë lekë apo rreth 500 mijë dollarë është vënë në dispozicion të një kontrate konsulencë për hartimin dhe zbatimin e reformave të të bërit biznes. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hapur tenderin, ndërkohë që ofertat do të pranohen deri në datën 5 prill. Sipas njoftimit të publikuar në Agjencinë e Prokurimit Publik, objektivi i përgjithshëm i këtij projekti, është përmirësimi i vlerësimit të indikatorëve për reformat e ndërmarra nga Shqipëria për krijimin e një mjedisi të favorshëm për të bërit biznes në vend, duke rritur konkurrueshmërinë e ndërmarreve dhe përmirësuar në tërësi situatën socio-ekonomike. Ndërkohë që, qëllimi i ekspertizës do të fokusohet në ofrimin e konsulencës për hartimin dhe zbatimin e reformave të të bërit biznes, si dhe për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative, përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave, në kuadër të përmirësimit të klimës së biznesit. Praktikisht fondi limit prej 500 mijë dollarësh do të shkojë për konsulencën në ofrimin e rekomandimeve praktike dhe të përshtatshme mbi reformat e të bërit biznes dhe në asistencën për hartimin, zbatimin dhe komunikimin e tyre tek palët e interesuara. Më konkretisht, shërbimet e konsulencës do të shkojnë në hartimin e një analize të thelluar të kuadrit aktual politik dhe ligjor, si dhe propozimi i nismave, reformave dhe instrumenteve ligjor apo rregullative, që do të lehtësojnë procedurat e të bërit biznes. Po ashtu, në përfundim të kontratës do të duhet të propozohen reforma konkrete për indikatorët përkatës, si: hapja e një biznesi, marrja e lejes të ndërtimit, furnizimi me energji, regjistrimi i pasurisë, marrja e kredisë, mbrojtja e investitorëve, pagesa e taksave, etj.

Avokati Ardian Visha: Vendimi është i padrejtë, do t'i drejtohem Kolegjit të Apelit

Vetingu, shkarkohet gjykatësi Kushtetues, Fatos Lulo

KPK: Nuk justifikon pasurinë me burime të ligjshme

Vetingu skualifikoi ditën e djeshme nga radhët e sistemit të drejtësisë, gjykatësin Kushtetues Fatos Lulo. Vendimi për shkarkimin e tij u mor pas një hetimi administrativ pesë muajor dhe zhvillimit të seancës dëgjimore publike. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi t'i ndërprejë karrierën gjykatësit, me arsyetimin se ai nuk e justifikon pasurinë e tij, një shifër prej gjysmë milioni dollarë. "Në përfundim të procesit të rivlerësimit trupë gjyqësore vendosi shkarkimin nga detyra të Fatos Lulo, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Lulos, Komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të KPK. Ky vendim apelohej nga Lulo 15 ditë nga data e njoftimit, ankimohet pranë KPK", tha kryetarja e trupës gjyqësore Genta Tafa Bungo. Vendimi për shkarkimin e gjykatësit erdhi pasi në raportin e përcjellë në KPK nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, për subjektin e rivlerësimit Fatos Lulo, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe deklarim të rremë të pasurisë.



Fatos Lulo

VENDIMI
Vendimi për shkarkimin e gjykatësit erdhi pasi në raportin e përcjellë në KPK nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, për subjektin e rivlerësimit Fatos Lulo, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe deklarim të rremë të pasurisë.

"Reforma, tregues pozitiv për çeljen e negociatave me BE-në"

Ministrja e Drejtësisë: Vendimi për shkarkimin e gjyqtarit garanton ecurinë e vetingut

Pas shkarkimit të gjyqtarit Fatos Lulo, i cili u skualifikua nga radhët e sistemit të drejtësisë pasi nuk e justifikon pasurinë e tij, ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka përsëritur vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. "Sot, zbatimi i Reformës në Drejtësi shënoi një hap tjetër të rëndësishëm, të shumëpritur. Qytetarët shqiptarë meritojnë një sistem drejtësie me gjyqtarë dhe prokurorë që besojnë në detyrën e rëndësishme që kanë marrë përsipër dhe mbrojnë vetëm interesin më të lartë të qytetarëve dhe shoqërisë dhe jo interesat e tyre personale financiare ose politike. Reforma në drejtësi, përkundër të gjitha përpjekjeve për ta dëmtuar apo penguar, po jep rezultatet e saj të njëpasnjëshme, duke garantuar jo vetëm suksesin e kësaj reforme, por edhe një tregues pozitiv



Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

"Qytetarët shqiptarë meritojnë një sistem drejtësie me gjyqtarë dhe prokurorë, që besojnë në detyrën e rëndësishme që kanë marrë përsipër dhe mbrojnë vetëm interesin më të lartë të qytetarëve dhe shoqërisë dhe jo interesat e tyre personale financiare ose politike".

për çeljen e negociatave me BE-në. Përgëzimet për fillimin e procesit vënie-marrës të vetingut i shkojnë jo vetëm Komisionit të Pa-

varur të Kualifikimit, por edhe kolegëve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit", shkruan ministrja.

shkojë Lulo në zyrë pas vendimit? Ai u pezullua deri në një vendimmarrje të Kolegjit të Apelit, tha avokati Ardian Visha. Sakaq i njëjti proces do të zbatohet edhe për gjyqtarë dhe prokurorë të tjerë. Ligji

parashikon që gjyqtarët dhe prokurorët që nuk justifikojnë dot pasuritë, përjashtohen nga sistemi. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit prej kohësh ka publikuar listën me 57 emra gjykatësish e prokurorësh, të cilët

po i nënshtrohen me përparësi Vetingut. Ata janë anëtarët e gjykatës Kushtetuese, anëtarët e gjykatës së Lartë, kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

EDI RAMA
"Të gjithë shqiptarët që e mbështetën fort vetingun, sot duhet të ndjehen mirë, sepse nisja është e mbarë. Pas 17 gjykatësve e prokurorëve që i ikën vetingut pa filluar, procesi nisi e i pari që u mor në pyetje s'e justifikoi dot pasurinë dhe ra! Jam i bindur s'kemi parë gjë akoma", - është shprehur kryeministri Rama.

VETINGU, LISTA

1. Altina Xoxhaxhi Gjykata Kushtetuese
2. Bashkim Dedja Gjykata Kushtetuese
3. Besnik Imeraj Gjykata Kushtetuese
4. Fatmir Hoxha Gjykata Kushtetuese
5. Fatos Lulo Gjykata Kushtetuese
6. Gani Dizdari Gjykata Kushtetuese
7. Vitore Tusha Gjykata Kushtetuese
8. Xhezair Zaganjori Gjykata e Lartë
9. Adriatik Lalla Prokuror i Përgjithshëm
10. Alma Brati Gj.Shk.I, Tiranë
11. Artan Laze Gj.Shk.I, Tiranë
12. Artan Zeneli Gjykata e Lartë
13. Astrit Faqolli Gj.Shk.I, Tiranë
14. Besim Trezhanjeva Gj. Apelit Durrës
15. Bledar Abdullai Gj.Shk.I, Tiranë
16. Brunilda Kadi Gj.Shk.I, Tiranë
17. Brunilda Kasmi Gj.Shk.I, Tiranë
18. Dritan Hallunaj Shk. I për Krimet e Rënda
19. Ilir Toska Gj. Apelit Tiranë
20. Manjola Xhaxho Gj.Shk.I, Tiranë
21. Marcela Shehu Gj.Shk.I, Kurbin
22. Medi Bici Gjykata e Lartë
23. Nertina Kosova Apeli Krimet e Rënda
24. Adriatik Cama Prokuroria Tiranë
25. Anila Leka Prokurori e Përgjithshme
26. Antoneta Sevdari Prokuroria Tiranë
27. Arben Dopallaj Prok. Apelit Shkodër
28. Arben Nelaj Prokuroria Tiranë
29. Arta Marku Prokuroria Shkodër
30. Besa Nikehasani Prok. Apelit Shkodër
31. Besnik Cani Prokuroria Elbasan
32. Besnik Muci Prok. Krimet e Rënda
33. Bujar Hoti Prokuroria Durrës
34. Dritan Prençi Prokuroria Kukës
35. Dritan Rreshka Prokuroria Tiranë
36. Elison Sadiku Prokuroria Korçë
37. Gentjan Osmani Prok. Krimet e Rënda
38. Kostaq Beluri Prokurori e Përgjithshme
39. Luan Kaloçi Prok. Apelit Tiranë
40. Ramadan Troci Prokurori e Përgjithshme
41. Shpëtim Kurti Prokuroria Tiranë
42. Vat Staka Prokuroria Shkodër
43. Brikena Ukperaj Lubonja Gj. Apelit Vlorë
44. Ervin Metalla Gj. Apelit Tiranë
45. Fatjona Memçaj Prok. Apelit Tiranë
46. Gentjan Medja Gj. Adm. Sh.I Tiranë
47. Gentjan Trenova Prok. Apelit Tiranë
48. Kastriot Selita Gj. Adm. e Apelit
49. Rovena Gashi Prokurori e Përgjith
50. Admir Thanza Gjykata e Lartë
51. Ardian Dvorani Gjykata e Lartë
52. Artan Broci Gjykata e Lartë
53. Edmond Islamaj Gjykata e Lartë
54. Shkëlzen Selimi Gjykata e Lartë
55. Tom Ndreca Gjykata e Lartë
56. Artur Malaj Gj. Adm. e Apelit
57. Marsida Xhaferllari Insp. e Lartë e Drejtësisë

Elsi Kosiqi, babai i 3 fëmijëve u qëllua për vdekje me tri plumba në gjoks

Dibër, ekzekutoi biznesmenin para shtëpisë, lihet në burg Mahmut Gega

24-vjeçari në gjykatë: Nuk jam unë vrasësi

DIBER

Nuk jam unë vrasësi". Kështu është shprehur ditën e djeshme përpara trupës gjyqesore, Mahmut Gega, i cili dyshohet si autor i vrasjes së 32-vjeçarit Elsi Kosiqi, tre ditë më parë në Maqellarë të Dibërës. Pavarësisht mohimit të akuzave nga 24-vjeçari Gega, gjykata e shkallës së parë Dibër, caktoi masën e sigurisë "arrest me burg", për të riun. Ngjarja e rëndë ndodhi katër ditë më parë, ku 32-vjeçari u ekzekutua në oborrin e banesës së tij. Dyshohet se vrasja ka ndodhur për motive të dobëta. Ndërkohë grupi hetimor, po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.

NGJARJA

Rreth orës 01:30, krismat e armës kanë terrorizuar pjesëtarët e familjes Kosiqi në Maqellarë. Në momentin që kanë dalë jashtë, ata kanë parë trupin e pajetë të 32-vjeçarit dhe menjëherë kanë sinjalizuar policinë, e cila ka mbërritur shpejt në vendng-



Autori i dyshuar, Mahmut Gega

jarje. Pas kryerjes së veprimeve paraprake, blutë kanë gjetur dhe sekuestruar në oborrin e banesës së kësaj familjeje dy gëzhoja kallashnikovi. Ndërkaq, burime konfidenciale nga policia pohuan se mëngjesin e së hënës, Elsi Kosiqi kishte shkuar në Dibër të Madhe ku kishte qëndruar me disa shqiptarë dhe një shtetas

maqedonas gjatë gjithë ditës, deri në mesnatë. Në orën 01:30 ai është kthyer në banesë, por sapo ka parkuar në oborr makinën e tij tip "Benz" para derës së shtëpisë, autori ka përfutur nga porta e hapur dhe është futur në oborr duke e qëlluar tri herë me armë zjarri. Ngjarja ka ndodhur te veranda e banesës. Më pas autori

është larguar me shpejtësi (ka përfutur nga errësira), duke qenë se shtëpia e familjes Kosiqi ndodhet vetëm disa metra larg nga rruga nacionale dhe 500 metra nga kufiri me Maqedoninë.

HETIMET

Vrasja e babait të tre fëmijëve ka alarmuar policinë, e cila është vënë në kërkim të autorit të krimit. Blutë

kanë ngritur postblloqe të shumta në rrugë, ndërsa kanë bërë krehjen e gjithë zonës. Pas ngjarjes, policia deklaroi se vrasësi/it mund të identifikohen shumë shpejt, pasi në ikje e sipër kanë lënë gjurmë në vendin e ngjarjes.

Vetëm në orët e vona të mbrëmjes së të martës, blutë kanë arritur të identifikojnë dhe të arrestojnë ekzekutorin e biznesmenit Elsi Kosiqi. Zyrtarisht, policia bëri me dije se krimi dyshohet të ketë ndodhur për motive të dobëta pa dhënë detaje të tjera për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Po sipas policisë, 32-vjeçari njihet si person problematik në zonë dhe se për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes po hetohet e shkuara e tij dhe e vrasësit të dyshuar Mahmut Gega. Në të njëjtën linjë kanë qenë dhe banorët e zonës. Këta të fundit janë shprehur se viktima kishte të kaluar të dyshimtë. Gjithashtu, banorët pohuan se autori i krimit dhe viktima kanë qenë kohë më parë emigrantë në Itali.

SHKURT

Sherr mes të rinjve në Laknas, qëllonjë me armë zjarri në ajër

Të shtëna me armë zjarri janë dëgjuar mbrëmjen e djeshme në periferi të kryeqytetit. Ngjarja ndodhi në zonën e Laknasit, ku pas konfliktit fizik mes dy të rinjve, njëri prej tyre ka qëlluar dy herë në ajër, ndërsa nuk raportohet për persona të lënduar. Efektivët e komisariatit, nr.5, shoqëruan në polici 2 shtetas që ishin edhe iniciatorët e konfliktit. Sherri banal dyshohet se ka nisur disa ofendimeve, ndërsa palët e përfshira në konflikt janë banorë të zonës së Laknasit. Policia ka sekuestruar edhe kamerat e sigurisë për të hedhur më shumë dritë mbi arsyet e konfliktit.

Aksidenti në Gjirokastrë-Tepelenë, vdes djali, plagoset rëndë babai

GJIROKASTER- Një i vdekur dhe një i plagosur është bilanci i një aksidenti tragjik të ndodhur pasditën e djeshme në rrugën Gjirokastrë-Tepelenë. Mësohet se një makinë është përplasur me një zetar, i cili i ka prerë rrugën pranë vendit të quajtur "Ura e Kardhiqit". Si pasojë e përplasjes ka humbur jetën shoferi i zëtorit, 35-vjeçari Klajdi Ngjelina, ndërsa i plagosur ka mbetur babai i tij Sali Ngjelina, i cili është dërguar në spitalin e Gjirokastrës, në gjendje të rëndë. Sakaq, policia e mbërritur në vendngjarje ka nisur hetimet për zbardhjet e plotë të rrethanave dhe shkaqeve të aksidentit.


Trafikonte lëndë narkotike, bie në pranga 58-vjeçari në Vlorë

VLORE- Policia e Vlorës ka vënë në pranga një 58-vjeçar, pasi i janë gjetur rreth 36.5 kg lëndë narkotike. Bëhet fjalë për shtetasin Bari Lamaj. Strukturat Policore të Seksionit kundër Narkotikëve në D.V.P.Vlorë, kanë arrestuar në flagrancë 58 vjeçar, banues në Trevizlazer, Vlorë, pasi si rezultat i një operacioni i ujet e sekuestrua në një territor toke të rrethuar me blloqe betoni e të poseduar prej tij një sasi lëndë narkotike Cannabis Sativa me peshore 36.5 kg. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprimet penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283 të Kodit Penal"- thuhet në njoftimin e policisë.

47-vjeçari, nën akuzë për falsifikim të dokumenteve

Skandali me pronat në Lezhë, lihet në burg organizatori Lek Frroku

LEZHË- Gjykata ka vendosur ditën e djeshme që të lërë në burg, Lek Frroku, të arrestuar pak ditë më parë pranë aeroportit të Rinanit, në kuadër të operacionit "Ranishtja 4". Frroku akuzohet për tjetërsimin e tokës në zonën e "Ranës së hedhun" në Shëngjin. 47-vjeçari ishte shpallur në kërkim për veprimet penale të falsifikimit të dokumenteve. Sipas prokurorisë Frroku dyshohet të jetë organizatori i skemës së tjetërsimit dhe është një përfituesit e tokës në bregdet, në mënyrë të paligjshme përmes kësaj skeme falsifikimi. Po ashtu ka dalë para gjykatës për rivlerësim të masës së sigurisë, Juxhina Mema, specialiste e kadastrës në Bashkinë e Lezhës, për të cilën gjykata ia në fuqi vendimin e saj të mëparshëm "Arrest në shtëpië." Gjykata ka lënë disa ditë më parë në masën e sigurisë në "arrest



Lek Frroku

me burg" edhe specialistët Ardenis Haxhia dhe Enkelejd Zefi, ndërsa 8 zyrtarë të tjerë janë në arrest shtëpie. Ndër personat e akuzuar në këtë aferë korruptive është edhe kryebashkiaku i Lezhës, Fran Frrokaj. Hetimit lidhur me këtë dosje kanë filluar mbi bazën e të dhënave të siguruar nga burime policore dhe ankime të qytetarëve. Në të eviden-

tohej tjetërsimi në kundërshtim me ligjin të disa pasurive shtetërore "ranishte dhe pyll", përgjatë bregut të detit në zonën e plazhit të fshatit Mali i Rencit dhe Mali i Shëngjinit, tek zona e quajtur "Rana e hedhun", si dhe pjesën e malit në shtatin e tij, sipër zonës së quajtur "Rana e hedhun", në njësinë administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.

Stomatologia kërkon lirinë, gjykata lë në fuqi masën 'arrest me burg'

DURRES- Gjykata e Apelit në Durrës ka lënë sërish në fuqi masën 'arrest me burg' për Olesia Dukën, e cila akuzohet për mashtrim. Pavarësisht kërkesës së Dukës për ndryshimin e masës së sigurisë, me pretendimin se kjo masë e dhënë ndaj saj është e padrejtë, gjykata vendosi të lërë në fuqi vendimin e mëparshëm. Avokatët mbrojtës të stomatologes, Arben Llangozi dhe Brikena Duka, kishin bërë ankimmimin, pas pretendimit se gjykata ka dhënë masë të rëndë ndaj klientes së tyre. "Gjykata i ka dhënë masën më të rëndë. Nga konstatimi që ne kemi vetëm denoncimin e shtetasit Idlir Hoxha. Konflikti është civil dhe jo penal. Kemi detyrim civil dhe jo penal. Gjykata penale nuk ka juridiksion sepse shtetasja Olesia Duka nuk ka konflikt penal. Olesia Duka nuk ka rrezik largimi, nuk ka arsye dyshimi që të largohet. Ajo është mjek stomatologe me dy fakultete. Nuk ka kushte të veçanta dhe kërkojmë ndryshim mase e vendosjen e një mase më të bute. Prokurori nuk ka bërë asnjë verifikim konkret. Prokurori duhet të bënte verifikim të shumave me bilanciçet e shoqërive tregtare. Nuk është bërë asnjë verifikim për vlerat financiare. Vëmë në dispozicion bilanciçet e shoqërive në original dhe nuk kanë ekzistuar kurrë ato vlera monetare. Klientja ka marrëdhënie kontraktuale me shoqëri tregtare. I kërkojmë gjykatës ndryshim mase. Kërkojmë 'arrest shtëpie' dhe në mbikëqyrje", thanë avokatët.

Permbuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :

* "Pretoria-Truallë-ndertese me sip totale 620m2, nga e cila 200 m2shite truallë dhe 90 m2 është ndërtesë , me Numër pasurie 43017, e ndodhur në Zonën Kadastrale 1100, e regjistruar në regjistrin hipotekorë volumi 6, faza 227 me adrese në Fshatin Barbulush Shkoder
2. Cmirri me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpershkruar, është në vlerën 1.568.000 (njemilione e pesëqind e gjashtëdhjetëteete mije) Lekë .

Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillimet) me date 26.03.2018 ora 16.16 në Zyren e përmbuesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

Të gjithë banorët që jetojnë në një prej 4 zonave administrative, ku aplikohet parkimi pa pagesë duhet të pajisen me Pullën e Rezidentit. Në faqen zyrtare të "Tirana Parking" bëhet me dije se të gjithë ata banorë që jetojnë në një prej këtyre zonave dhe nëse kanë një automjet, duhet të paraqiten në zyrat e saj për t'u pajisur falas me Pullën e Rezidentit, çka do t'u mundësojë atyre parkim pa pagesë. Gjithashtu, "Tirana Parking" thekson se vërtetimet e marra për rez-



Vërtetimet e rezidentit për 2017-ën, të pavlefshme

Parkim pa pagesë në 4 zona në Tiranë, ja si ta përfitoni

ident në vitin 2017 nuk janë më të vlefshme dhe se edhe këta qytetarë duhet të pajisen me Pullën e re të Rezidentit. Ndërkohë që për të shmangur çdo lloj abuzimi me Kartën e Rezidentit, kjo agjenci ka rritur edhe më tej elementët e sigurisë. Kartat e

Rezidentit do të ofrohen për afatin kohor 12-mujor nëpërmjet një pulle identifikuese, e cila është "e personalizuar" dhe do të duhet të vendoset brenda xhamit, në pjesën e përparme të automjetit, "lehtësisht e dukshme" ku shënohet targa e autom-

jetit, afati i vlefshmërisë, numri serial, si dhe numri i zonës. Gjithashtu, vendet të cilat janë të përcaktuara për rezidentët nuk janë të personalizuara, që do të thotë se në këto hapësira kanë të drejtë të parkojnë të gjithë banorët që janë rezidentë të asaj zone.

Kjo kartë do mund të përfitohet nga qytetarët rezidentë, vetëm pasi të jenë dorëzuar dokumentet që vërtetojnë se qytetari është rezident në një zonë të caktuar, përkatësisht: certifikatë familjare, vërtetim banimi, kopje e certifikatës së pronësisë ose kontratës së qirase/huapërdorjes, certifikatë për vërtetim pronësie e makinës ose autorizim për përdorim automjeti, leje qarkullimi e automjetit që do të pajiset me kartë rezidenti, fotokopje e taksave vjetore të makinës si dhe një fotokopje e fatursë së UKT-së ose OSHE-së.

Qendra e Shërbimeve Arsimore: Kalandari me datat sipas qyteteve, në DAR/ZA-t përkatëse

Voltiza Duro

Matura Shtetërore 2018, shpallen afatet e plotësimit të formularëve

Ja kush ka të drejtë të aplikojë për A1 dhe A1Z

Të gjithë maturantët e vitit shkollor 2017-2018, do të kenë mundësinë të aplikojnë online për formularin A1 që prej 26 marsit deri në 10 prill të këtij viti. Qendra e Shërbimeve Arsimore ka publikuar kalendarin me datat përkatëse sipas të cilave maturantët më qytete të ndryshme do plotësojnë formularin A1 apo A1Z. "Aplikimi në Portalin Matura Shtetërore 2018 do të kryhet në periudhën 26 mars-10 prill 2018, sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi. Formulari A1 plotësohet online vetëm nga maturantët e vitit shkollor 2017-2018. Aplikimi online me Formularin A1 bëhet në shkollën ku maturanti vazhdon mësimin", theksohet në njoftimin e QSHA-së. Ndërkaq, procesi i plotësimit të Formularit A1 do të ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtorja e shkollës, që quhet "mbikëqyrës".

FORMULARI A1Z

Maturantët përpara vitit 2018 kanë afat që prej datës 12-17 prill të këtij viti për të plotësuar formularin A1Z. Qendra e Shërbimeve Arsimore bën me dije se formulari A1Z mund të plotësohet nga kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2018 dhe që kanë detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore; si dhe nga kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2018 dhe që nuk kanë detyrime të Maturës Shtetërore. Gjithashtu, edhe kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit dhe, pasi kanë bërë njehsimin e diplomës në komisionin përkatës, rezultojnë se kanë ose nuk kanë detyrime të Maturës Shtetërore kanë të drejtë të plotësojnë formularin A1Z. Plotësimi online i Formularit A1Z bëhet në shkollat ku kandidatët kanë kryer arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja e vendbanimit, nëse shkolla e mesme që kanë përfunduar është mbyllur. Për të plotësuar formularin A1Z, kandidatët duhet të paraqesin tek mbikëqyrësi një kopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë apo vërtetimit,



Foto ilustruese

MATURA SHTETËRORE 2018

Aplikimi on-line i formularëve A1 dhe A1Z do të realizohet nëpër DAR/ZA sipas planit kalendar të mëposhtëm:

Aplikimi me Formularin A1 (Maturantët 2018)										
Date	Aplikuesit në Qytetet									
26.03.2018	Tirana Qytet	Tirana Qark	Kamëz	Kavajë	Durrës	Krujë				
27.03.2018	Tirana Qytet	Tirana Qark	Kamëz	Kavajë	Durrës	Krujë	Elibasan	Peqin	Gramsh	
28.03.2018	Tirana Qytet	Durrës	Kavajë	Kamëz	Krujë					
29.03.2018	Elibasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll		
30.03.2018	Fier	Mallakastrë	Lushnjë	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll		
03.04.2018	Berat	Kuçovë	Skrapar	Fier	Mallakastrë	Lushnjë	Shkodër			
04.04.2018	Shkodër	M. e Madhe	Pukë	Berat	Kuçovë	Skrapar	Kukës	Tropojë		
05.04.2018	Kukës	Has	Tropojë	Lezhë	Kurbin	Mirditë	Dibër	Mat		
06.04.2018	Dibër	Mat	Bulqizë	Vlorë	Sarandë	Gjrokastrë	Tepelenë	Përmet		
10.04.2018	Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjrokastrë	Tepelenë	Përmet				

Aplikimi me Formularin A1Z (Maturantët përpara vitit 2018)										
Date	Aplikuesit në Qytetet									
12.04.2018	Tirana Qytet	Tirana Qark	Durrës	Kavajë	Krujë	Kamëz	Mirditë			
13.04.2018	Tirana Qytet	Tirana Qark	Dibër	Vlorë	Gjrokastrë	Peqin	Gramsh	Librazhd	Sarandë	Skrapar
16.04.2018	Elibasan	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll	Berat	Kuçovë	Kurbin	Kukës	Mat
17.04.2018	Fier	Mallakastrë	Tepelenë	Lushnjë	Shkodër	M. Madhe	Lezhë	Bulqizë	Has	Tropojë

me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, me fotografat si dhe certifikatën e maturës me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, lëshuar nga drejtori i shkollës, sipas regjistrimit të

amzës apo dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit. "Edhe procesi i plotësimit të Formularit A1Z do të ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtorja e shkollës, që quhet "mbikëqyrës", thuhet

në njoftimin e firmosur nga drejtoresha e QSHA-së, Reza-na Vrapit. Në njoftim theksohet më tej se aplikimi online i formularëve A1 dhe A1Z do të realizohet nëpër DAR/ZA sipas planit kalendar. Në peri-

AFATET

"Aplikimi në Portalin Matura Shtetërore 2018 do të kryhet në periudhën 26 mars-10 prill 2018, sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi. Formulari A1 plotësohet online vetëm nga maturantët e vitit shkollor 2017-2018. Aplikimi online me Formularin A1 bëhet në shkollën ku maturanti vazhdon mësimin", theksohet në njoftimin e QSHA-së.

VERIFIKIMET

Në periudhën 11-20 prill 2018, do të plotësohet online baza e të dhënave me fushat përkatëse, sipas udhëzimit të dërguar nga QSHA-ja. Në të gjitha ato raste kur të dhënat mund të mund të kenë gabime, maturantët kanë mundësinë që të dërgojnë vërejtjet e tyre për pasaktësitë e deri në 30 prill 2018-të bëhen të gjitha korrigitimet e nevojshme në sistem.

RREGULLORJA

Sipas rregullores, provimet e maturës zhvillohen vetëm me shkrim për të gjithë ata që kanë mbyllur me sukses vitin e fundit të shkollës së mesme, ndërkohë nxënësit që kanë marrë më pak se 20% të pikëve të testit konsiderohen mbetës. Në testimet e Maturës Shtetërore 2018, kanë të drejtë të hyjnë maturantët që kanë bërë plotësimin e formularit A1 apo A1Z që do të miratohen nga MASR brenda datës 9 mars të këtij viti. Më tej në rregulloren theksohet se për shkollat profesionale dhe shkollat e mesme të orientuara, në rastet kur kandidatit ka fituar dëftësinë e pjekurisë, si provime të detyruara njihen: letërsia dhe matematika (nëse janë dhënë dhe janë fituar); ose një ose dy nga provimet në mungesë të tyre, sipas planit mësimor të shkollës. Gjithashtu, në nënin 15 të rregullores theksohet se kandidatët nuk lejohen të rijapin provimet me zgjedhje, nëse në maturat e viteve të mëparshme, rezultatet janë më të ulëta se 4.50 e në rastet kur maturantët e kanë dhënë më shumë se një herë një lëndë apo ato me zgjedhje, iu njihet vetëm rezultati i fundit.

TESTIMI

udhën 11-20 prill 2018, Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore dhe Komisioni i Maturës Shtetërore pranë drejtorive apo zyra arsimore do të plotësojnë online bazën e të dhënave me fushat përkatëse, sipas udhëzimit të dërguar nga QSHA-ja. Në të gjitha ato raste kur të dhënat mund të mund të kenë gabime, maturantët kanë mundësinë që të dërgojnë vërejtjet e tyre për pasaktësitë e deri në 30 prill 2018-të bëhen të gjitha korrigitimet e nevojshme në sistem.

Maturanti paraqitet në qendrën e provimit, 1 orë e 30 minuta përpara fillimit të provimit. Në momentin e paraqitjes në mjediset e provimit, duhet të ketë dokumentin e identifikimit dhe mjetet e nevojshme, si: laps, vizore, kompas, makinë të thjeshtë llogaritëse. Maturantët që dorëzojnë testin, firmosin për dorëzimin e tij në listën që disponon AP-ja. Kandidatët që dorëzojnë testin e provimit përpara kohës së përcaktuar, nuk mund të dalin nga qendra e provimit, para kohës së përfundimit.

Këtë vit do të diplomohet 30 menaxherët e parë shëndetësorë në vend, të cilët para nuk kanë pasur një kualifikim të mirëfilltë. Ditën e djeshme u zhvillua ceremonia e lancimit të masterit profesional të menaxherëve të shëndetësorë ku merrnin pjesë edhe ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, diplomatja zviceriane Ruth Huber, drejtore e Bashkëpunimit me Europen Lindore në Ministrinë e Jashtme të Zvicrës; drejtues të universiteteve, si dhe vetë studentët e programit. Ky program do të kombinojë njohuritë nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Ekonomisë në Tiranë, mbështetur nga qeveria zviceriane përmes projektit

Ogerta Manastirliu: Ka qenë pikë e dobët në sistem Prezantohet masteri i parë për menaxherët shëndetësorë, diplomim për 30 studentë

PËRFITIMET

"Nuk duhet fshehur se menaxherët në shëndetësi kanë qenë një pikë e dobët e sistemit. Ndaj ky program i parë i menaxhimit shëndetësor do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, duke nxjerrë brezin e parë të menaxherëve të shëndetësisë", - tha Manastirliu.

"Shëndet për të Gjithë". Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fakulteti i Mjekësisë në Tiranë, mbështetur nga qeveria zviceriane përmes projektit

njerëzore. "Nuk duhet fshehur se menaxherët në shëndetësi kanë qenë një pikë e dobët e sistemit. Ndaj ky program i parë i menaxhimit shëndetësor, një program inovator që nuk ekzistonte në

universitetet publike në Shqipëri deri para vitit 2017, patjetër që do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, duke nxjerrë brezin e parë të menaxherëve të shëndetësisë, kaq shumë të nevojshëm për vënien në zbatim të politikave tona për fuqizimin e shërbimit shëndetësor në vend", - tha Manastirliu. Faktikisht, ka pasur ose menaxherë që dinin nga fakulteti i ekonomikë ose profesionistë të shëndetësisë, por asnjëherë më parë



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu

programe të mirëfillta që të përfshijnë dy universitetet e Tiranës. Ambasadorja Huber theksoi se Zvicra është shumë e nderuar të mbështesë iniciativat të tilla që kontribuojnë në fuqizimin e burimeve njerëzore. Ndërsa rektori i Universitetit të

Mjekësisë prof. Arben Gjata dhe dekani i Fakultetit Ekonomik prof. Dhori Kule shprehën angazhimin e tyre për të përmbytur me sukses këtë program për studentët nga Shqipëria dhe Kosova, përmes lektorëve më të mirë të dy universiteteve.

Njoftimi/ Rastet kur mund të rrezikoni për të mos shkelur më kurrë në tokën amerikane

Rregullat që duhet të ndiqni kur ikni me vizë turistike në SHBA

Ambasada: Ja sa kohë mund të qëndroni, si të bëni rinovim

Voltiza Duro

Të gjithë ata persona që kanë përfutur një vizë turistike drejt SHBA-së, duhet të jenë të kujdesshëm dhe të ndjekin me përpikëri kërkesat gjatë periudhës që do të jenë në këtë shtet. Ky njofim është bërë ditën e djeshme në faqen zyrtare të ambasadës amerikane, e cila paralajmëron se nëse thyhen rregullat, ekziston rreziku për të mos hyrë më në tokën e Shteteve të Bashkuara. "Sigurohuni që të ndiqni kërkesat e vizës tuaj gjatë kohës që jeni në SHBA në mënyrë që të mos rrezikoni mundësinë tuaj për të udhëtuar në të ardhmen", theksohet në njofim. Ndërkohë, këshilluesit pranë ambasadës bëjnë me dije se viza turistike është vetëm për qëndrim apo vizitë për një kohë të shkurtër në SHBA, zakonisht për aq kohë sa aplikanti ka deklaruar në intervistë. Ka tre vjeçare do të thotë që individit mund të udhëtojë përsëri vitet pasardhëse për të njëjtin periudhë kohe që i ka deklaruar konsullit, apo që ka shkruar në aplikimin për vizë. "Kini parasysh që viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA e nuk është për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. Përndryshe, ju mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të emigracionit. Nëse oficeri i emigracionit ngre dyshime që qëllimi juaj i vizitës nuk është turistik, por për punë, juve mund t'ju revokohet vizën. Në të gjitha ato raste kur viza ka skaduar në më pak se një vit nga data e aplikimit, apo kur kandidati po aplikon për të njëjtin kategori vize nga po e njëjta konsullatë, i lind e drejta të bëjë një kërkesë për rinovim vizë. Kjo e fundit mund të kryhet edhe në rastet kur personi nuk ka qenë i dënuar më parë si dhe i përgjigjet saktë pyetjeve të logjaria e tij në adresën online <https://ais.usvisa-info.com/en-al/niv>. Në fund të regjistrimit, kjo faqe udhëzon aplikantët nëse kualifikohen për rinovim vize me postë, apo nëse ju duhet të caktojnë një datë interviste. "Nëse ju shfaqet kalendari i takimeve, kjo do të thotë që ju duhet të caktoni takimim tuaj për t'u paraqitur personalisht", thekson ambasada. Vizat joemigruese drejt SHBA-së, kategorizohen në viza biznesi, turistike dhe ato për trajtime mjekësore. Këto lloje vizash jepen personat që dëshirojnë të hyjnë në Shtetet e Bashkuara për kërkime shkencë ose përfshirë pjesëmarrjen në takime ose konferenca profesionale; për kënaqësi, duke përfshirë pushime ose vizita familjare ose trajtim mjekësor (B2) ose një kombinim i të dyja qëllimeve (B1 / B2) deri në gjashtë muaj. Individit që udhëtojnë në mes të dy shteteve të huaja që duhet të bëjnë një lidhje në Shtetet e Bashkuara si pjesë e atij udhëtimit.



KUSHTET E QËNDRIMIT

"Kini parasysh që viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA e nuk është për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. Përndryshe, ju mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të emigracionit. Nëse oficeri i emigracionit ngre dyshime që qëllimi juaj i vizitës nuk është turistik, por për punë, juve mund t'ju revokohet vizën", - tha ambasada.

total në tokën amerikane e gjatë kësaj periudhe është e ndaluar puna në këtë shtet. **RINOVIMI I VIZËS TURISTIKE** Në faqen zyrtare të ambasadës, gjithashtu, theksohet edhe procedura që duhet ndjekur për rinovimin e vizës. Në të gjitha ato raste kur viza ka skaduar në më pak se një vit nga data e aplikimit, apo kur kandidati po aplikon për të njëjtin kategori vize nga po e njëjta konsullatë, i lind e drejta të bëjë një kërkesë për rinovim vizë. Kjo e fundit mund të

RINOVIMI

Në të gjitha ato raste kur viza ka skaduar në më pak se një vit nga data e aplikimit, apo kur kandidati po aplikon për të njëjtin kategori vize nga po e njëjta konsullatë, i lind e drejta të bëjë një kërkesë për rinovim vizë.

konferenca profesionale; për kënaqësi, duke përfshirë pushime ose vizita familjare ose trajtim mjekësor (B2) ose një kombinim i të dyja qëllimeve (B1 / B2) deri në gjashtë muaj. Individit që udhëtojnë në mes të dy shteteve të huaja që duhet të bëjnë një lidhje në Shtetet e Bashkuara si pjesë e atij udhëtimit.

VIZAT E PUNËS

Akti i Emigracionit dhe Kombësisë parashikon disa kategori të vizave jo-emigruese për një person që dëshiron të punojë përkohësisht në Shtetet e Bashkuara. Qendra Kombëtare e Vizave (NVC) fillon procedurën e mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm disa muaj përpara se çështja e kandidatit të jetë aktuale, në mënyrë që ai të mos humbasë kohë me këtë procedurë dhe çështja të jetë gati sapo të jetë aktuale. "Unë mendoj që sapo çështja juaj të jetë aktuale sipas buletinit të vizave, NVC do t'ju caktojë takimim. Kjo edhe sepse ne si Seksion Konsullor i kemi dërguar NVC-se kuota të mjaftueshme për caktime takimesh. Buletini i vizave ndryshon çdo muaj. Shikoni datën në kolonën "All Chargeability Areas Except Those Listed" për kategorinë e vizës suaj. Të gjitha peticionet e dorëzuara përpara asaj date janë aktuale për t'u shqyrtuar", - theksojnë këshilltarët pranë Ambasadës Amerikane në Tiranë.

NJOFTIM

Studio Përmbarimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e II (Dytë) për pasurinë:
a. Pasionia Nr.2/32+1-8/1, vol 6, faqe 183, Z.K.8514, e apartament, me sipërfaqe totale 70,13m2, e ndodhur në Durrës, çmimi 27.490.4 Euro.
Ankandë zhvillohet në datë 26.03.2018 në ambientet e Studios Përmbarimore Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.0682089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORIS LITUM" (EOC LIT) sh.p.k
Shoqëria Përmbarimore "Executores Litum" sh.p.k
do të zhvillojë ankandin e garës për pasuritë e pasulljshme :
"Trruall me nr.pasurie 45/8, me sip. 4392 m2, ZK 1006, vol 01, fq.197, e ndodhur në Ahmetq Tiranë
në pronësi të Petriti Shafiqel Elzi
Çmimi me të cilin do të fitojë ankandë është me vlerën 119.008 Euro
Nderlesë me nr. pasurie N/45/8, me sip. 1167 m2, ZK 1006, vol 9, fq.197, e ndodhur në Ahmetq Tiranë
në pronësi të Petriti Shafiqel Elzi, Altin Dervishi, Ermir Stafaj.
Çmimi me të cilin do të fitojë ankandë është me vlerën 208.312 Euro
Ankandë do të zhvillohet në datë 06.04.2018 ora 16:00, në zyrën përmbarimore "Executores Litum" sh.p.k, me adresë Bllv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tiranë.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 602

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 24 mars 2018

SARA & LEDIONI:

Së shpejti vjen dasma "sekrete"



*Katër vite bashkë, në 2018-ën
kurorëzohet dashuria e çiftit
të 'TopMedias'. Qindra të ftuar
VIP dhe larg syve të medias,
ja ku do të zhvillohet ceremonia*

GJITHMONE BASHKE!

**KLEVI KUDO
ME SONIN,
EDHE NE
PROVAT
E "DWS"**




GENA DHE ANESTI:

**NA LIDHI
DASHURIA
PER
MUZIKEN**



Almeda xheloze?! “Po e pranoj, por...”

Në një rrëfim për një media televizive, bukuroshja shqiptare Almeda Abazi ka treguar edhe pjesë nga martesja e saj me aktorin e njohur turk, Tolgahan Saygıman. Ajo tha se në këtë periudhë, ai ka qenë mjaft i ngarkuar dhe madje i duhet të udhëtojë dhe në Afrikë për shkak të fansave të shumtë me telenovelën e tij të fundit. E pyetur nëse ndihej xheloze për fansat e tij apo për të gjitha vajzat e bukura që mund të ketë kontakt, Almeda u shpreh që “po”. Por gjithashtu aktorja bukuroshe u shpreh se ajo e dinte shumë mirë se çfarë e priste kur u lidh me Tolgahan, për faktin që e kupton shumë mirë punën e tij. Ajo e mirëkupton bashkëshortin e saj për shkak të profesionit, edhe pse mund të ndihet xheloze, nuk ia shpreh diçka të tillë.



Gjithmonë bashkë! Klevi kudo me Sonin, edhe në provat e “DWS”

Para pak kohësh, mësuam se këngëtarja Soni Malaj do të rikthehej të ishte pjesë e edicionit special të “Dancing With The Stars”, i cili nisi mbrëmjen e djeshme. Përveç karrierës së saj, këngëtarja seksi ka qenë në qendër të vëmendjes edhe sa i përket lidhjes së saj me Klevin. Duket se ai është padyshim një mbështetje mjaft e madhe për këngëtarën e njohur. Gazeta “Express” ka siguruar një foto gjatë provave të “Dancing With The Stars”, ku e shohim Sonin së bashku me Klevin, ndërkohë që po presin të nisin provat. Gjatë gjithë kohës ata kanë qëndruar në shoqërinë e njëri-tjetrit, duke u shfaqur më të dashuruar së kurrë.



Ami bëhet nostalgjike, poston fotot e vjetra me një urim special

Mbrëmjen e djeshme nisi spektakli “Dance with the stars”, edicioni special. Ami mesa duket është bërë nostalgjike nga periudha kur e drejtonte vetë dhe nga kjo ka marrë shkas të bëjë një urim special për të gjithë stafin, të cilit Ami do i mungojë këtë vit. “Sot dua t’i uroj suksese për premierën skuadrës së ‘dwtshalbania’ me të cilët kam kaluar disa sezone pune të mrekullueshme! Format im i preferuar! Jam e sigurt që ky sezon do jetë vërtetë ‘All stars’! @hkolaneci do na surprizash, siç ke bërë çdo edicion! Urime stafit #bledlinza @ardiasllani @eraldorexho @zefinahasani @ilir_shaqiri @emaandrea1 #alfredkacinari @almeda92 @rud_hizmo, gjithë trupës së baletit dhe VIP-ave! (kaq foto gjeta në cel. për momentin”, ishte urimi i Ami për të gjithë stafin e spektaklit që drejtoi disa vite me radhë. Këtë herë spektakli do të prezantohet nga e bukura Almeda Abazi, e cila ka ardhur enkas nga Turqia dhe moderatori Rudi Hizmo.



Hapen arkivat! Luana Vjollca nxjerr fotot që askush s’i ka parë

Nuk është risi tashmë që VIP-at i rikthehen pas së shkuarës me fotot kur kanë qenë fëmijë. Nëpër rrjetet sociale kanë dalë në dritë disa foto që tregojnë se si dukej fëmijë një nga moderatorët më seksi të ekranit. Luana Vjollca është gjithmonë në qendër të komenteve për pamjen e saj të zjarrtë. Format bombastike e kanë shndërruar në një Kardashian të vërtetë. Për jetën e saj, gjithmonë ka kureshtje dhe aq më tepër për kohën kur ajo ishte një fëmijë. Fotot e publikuara tregojnë një fëmijë të ëmbël dhe me flokë të zeza. Vështirë ta dallojmë që nga fëmijë e deri në ditët e sotme. Luana mbetet një bombë e vërtetë!



Katër vite bashkë, në 2018-ën kurorëzohet dashuria e çiftit të "TopMedias"



SARA DHE LEDIONI: Së shpejti vjen dasma "sekrete"

Qindra të ftuar VIP dhe larg syve të medias, ja ku do të zhvillohet ceremonia

A ta janë padyshim një nga çiftet më të rezervuar të "showbiz"-it shqiptar. Prindër të një vogëlushi të ëmbël të quajtur London Noor, më në fund Sara Hoxha dhe Ledion Liço do të martohen këtë verë. Burime për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" thanë se këtë vit, pikërisht në gusht të 2018-ës, çifti do të kurorëzojë dashurinë e tyre katërveçare larg syve të medias dhe kureshtarëve të tjerë. Në një ceremoni tepër intime, Sara dhe Ledioni kanë vendosur t'i thonë "po" kurorëzimit të dashurisë në një nga vendet më romantike. Nuk po flasim këtu aspak për ndonjë vend në Shqipëri, përkundrazi, ata vendosën të celebren në Como të Italisë. Këtë verë do të jenë dëshmitarë të këtij momenti kaq të rëndësishëm të tyre edhe 200 të ftuar VIP. Por sipas burimeve, ende nuk janë shpërndarë

ftesat zyrtare, ndërkohë që miqtë dhe të afërmit e çiftit janë njoftuar për datën si dhe për vendin ku do të zhvillohet dasma e shumëpritur. Me siguri që pas një pritjeje kaq të gjatë dhe pas ardhjes në jetë të frutit të tyre të dashurisë, eventi i radhës do të jetë padyshim një nga ngjarjet më të paharruara për çiftin, por gjithashtu edhe për të ftuarit e familjarët.

Por si ka nisur historia e dashurisë së tyre?

Pikërisht në vitin 2014, kur Ledioni ishte 26 vjeç dhe Sara 18 vjeçe, të dy kanë qëlluar shpesh në të njëjtat evente të "Top Channel". Por vetëm në pranverë të atij viti, mesa duket të dy e kuptuan se



ndanin shumë të përbashkëta. Dashuria e tyre është mirëpritur edhe nga familja Hoxha, madje Ledioni ka qenë edhe me pushime me Sarën jashtë Shqipërisë. Sara ka zbuluar se si janë njohur të dy. Ka qenë pikërisht gjatë koncertit të këngëtarit John Legend. Ajo ka postuar

një video teksa John Legend këndon "All of me" dhe shkruan se ajo dhe Ledioni janë lidhur nën tingujt e kësaj kënge. "Ledioni dhe unë u lidhëm fillimisht në një festë ditëlindjeje kur po luhej kjo këngë. Pas kësaj, e kemi dëgjuar këtë këngë në 829.273 dasma", shkruan Sara. Ndërkohë që përse i përket lajmit për dasmë në 2018, Sara Hoxha e vënë përballë motrës së saj, Lorit dhe Luana Vjollcës, është vënë para dy alternativave.

E para ishte të pinte një gotë alkoool ose të tregonte se kur do të martohet me Ledion Liço. Sara ka zgjedhur të tregojë vetëm vitin, pikërisht këtë vit. Pas kaq shumë tentativash për ta fshehur e për të qenë sekrete, një dasmë e tillë padyshim që do të jetë supermadhështore. Në një vend romantik si Como i Italisë, në një ceremoni intime, dasma e një nga vajzave të pranarit të "Top Medias" dhe moderatorit të njohur Ledion Liço, do të jetë dasma e vitit!



Qetesohuni njerëz, është thjesht një këngë!
Have been single, gonna stay single!

E dashuruar? Më në fund ish-banorja e 'BB9' rrëfen të vërtetën

Kohët e fundit, ish-banorja e "Big Brother 9" u përfol për një histori të re dashurie. Armela Hyseni me anë të një postimi në "InstaStory" i falënderonte miqtë e saj teksa e uronin për "dashurinë e re" me këngën e '2Ton', që përfshin vargjet: "Shumë urime për dashurinë e re...". Menjëherë pas kësaj, ajo ka treguar se është e gjitha një këngë dhe se vajza seksi e "BB9" do të vazhdojë të jetë vetëm edhe për ca kohë. "Qetesohuni njerëz, është thjesht një këngë! Kam qenë dhe do vazhdoj të jem beqare", - ka shkruar ajo në "InstaStory".

Vogëlushja e modeles së njohur ka ditëlindjen, ja si festojnë nënë e bijë!

Ajo njihet si një nga modelet më të njohura botërore, e cila është shndërruar edhe në ambasadoren e vendit tonë. Shpesh publikon video të ushqimeve shqiptare apo edhe të veshjeve tona popullore. Por në të nuk mungon as vogëlushja e saj, Ella. Ndërkohë që dje, Emina Cunmulaj ka publikuar në rrjetet sociale një video ku tregon se është duke festuar ditëlindjen e të voglës së saj. Në video vogëlushja duket mjaft e lumtur që po feston 2-vjetorin e lindjes. "Unë do ia dërgoja asaj në shkollë, kështu mund të festonte me shokët e saj, por është e sëmurrë, kështu që po e festojmë në shtëpi", - ka shkruar Emina krahas videos me vogëlushen e saj. Ndërkohë që së shpejti ajo do të sjellë në jetë fëmijën e saj të dytë, që me shumë gjasa, nga videot e mëparshme të dhuratave të marra për bebushin është vajzë. Por modelja ende nuk e ka konfirmuar, kështu që jemi në pritje!






Pej kohësh i shohim në një bashkëpunim së bashku. Ai është një nga këngëtarët më të kërkuar të momentit në vend si dhe në diasporë, ndërsa bashkëpunëtori i tij, një organist, i cili është po ashtu i kërkuar në tregun muzikor. Po flasim pikërisht për Genën dhe organistin e tij, Anesti Cenko. Në një intervistë të përbashkët ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" dyshja flet për marrëdhëniet e tyre në punë dhe jashtë, si lindi bashkëpunimi si dhe projektet më të fundit që do të nxjerrin në muzikë.

Pamela Aliaj

ANESTI CENKO

Si nisi bashkëpunimi me Genën?

Për sa i përket bashkëpunimit me Genën nuk mund të them që ishte rastësi takimi. Kam qenë unë që kërkoja momentin kur Gena ishte i ftuar në një nga klubet e Tiranës edhe i prezantohem duke treguar interes për të bashkëpunuar me të! I tregova të gjithë materialet që kisha përgatitur për të dhe kështu filloi gjithçka.

Si janë marrëdhëniet me Genën jashtë pune? Po marrëdhëniet në punë?

Marrëdhëniet me Genën janë të përkryera si në punë edhe jashtë pune. Arrimë të merremi vesh më së mirë, sepse bashkohemi edhe në konceptin e muzikës. Nëse arrin ta kuptosh atë çfarë ai ka në kokë (për sa i përket punës) mendoj se ke kuptuar mënyrën e tij të punës.

Keni pasur ndonjë incident të vogël?

Kjo gjë nuk ka ndodhur ndonjëherë edhe besoj se nuk do ndodhi sepse, siç thashë, ne kuptohemi shumë mirë në marrëdhënien e punës edhe jashtë saj.

Si nisi udhëtimi në botën e muzikës?

Kam qenë nga ata fëmijë që kisha shfaqur talentin dhe dëshirën time drejt instrumentit të baterisë që në moshën 4-vjeçare. Edhe prindërit e mi e kuptuan që



Flet ish-organisti i "C'est la vie": Si kanë qenë fillimet e mia

GENA DHE ANESTI: Na lidhi dashuria për muzikën

Rrëfëhet këngëtarit: Së shpejti me një bashkëpunim të ri muzikor

më pëlqente muzika dhe si domos të luaja në bateri. Por me kalimin e viteve kuptova se veten e gjeja me mirë në piano se në bateri.

Ka qenë gjithnjë zgjedhja juaj e parë muzikë?

Sigurisht kanë qenë prirjet e mia dhe dëshira për t'u

marrë me muzikë dhe mund të them që finalizimi i rrugëtimit ka qenë universiteti.

Cili ka qenë bashkëpunimi që ju ka lënë më tepër mbresa?

Të them të drejtën çdo bashkëpunim ka bukurinë e vet, sepse karakteret e



këngëtarëve kanë qenë të ndryshme. Nuk marr shkas se po punoj me Genën, por ai ka një veçanti, në atë çfarë ai transmeton te publiku edhe te mua si koleg. Energjia e tij është për t'u admiruar.

Keni ndonjë projekt të fundit të cilin jeni duke e përgatitur?

Gjithmonë mendojmë për projekte të reja. Plane kemi shumë. Tani për tani nuk dua të zbuloj asgjë, por shumë shpejt do kemi diçka të bukur.

Cili është orientimi muzikor që preferoni më tepër?



rast mund të veçoni?

Në përgjithësi natyra ime është paqësore dhe nuk krijoj konflikte me asnjë. Kjo shihet besoj dhe ndër vite që unë nuk kam pasur ndonjëherë sulme ndaj asnjë kolegu. Gjithmonë shoh punën tim e nuk jam natyrë që merrem me llafe. Madje i shmangem komplet kur ka të tilla situata.

Gena është një këngëtar i lidhur shumë ngushtë me muzikën, i kërkuar edhe në diasporë. E keni menduar të vijoni karrierën muzikore në Shqipëri apo jashtë vendit, si shumë këngëtarë që janë larguar?

Unë mendoj se "Guri i rëndë peshon në vend të vet" por kjo për sa më përket mua, sepse në rastin e disa artistëve me prejardhje shqiptare që janë në tregun ndërkombëtar si Rita Ora, Bebe Rexha, Dua Lipa, mendoj se është për t'u vlerësuar se si kanë arritur të deportojnë në industrinë muzikore botërore. Por ato ia kanë dalë më së miri dhe jemi të gjithë krenarë për këtë.

Nëse do zgjidhni të largoheshit, përse do të ishte?

Në qoftë se do të zgjidhja të largohesha nga vendi im, do të ishte vetëm për të zgjeruar karrierën time artistike. Mendoj se çdo artist po njësoj do mendonte! Kjo jo vetëm për artin, por në çdo lloj fushe!

A do të preferonit ju që vajzat tuaja të zgjidhnin rrugën e muzikës? Cila nga ato e ka më tepër pasion?

Pse jo? Në qoftë se do t'iu pëlqente dhe do kishin talent, s'do ishte keq! Të dyja e kanë pasion si çdo vajzë në atë moshë! Unë i kam lënë të lira të zgjedhin vetë profesionin që duan të bëjnë.

Unë kam luajtur shumë stile muzikore, sepse edhe puna ndër vite ma ka kërkuar këtë gjë, aq më tepër dhe bashkëpunimet që kam pasur me këngëtarë të rrymave të ndryshme. Unë personalisht preferoj një muzikë që ne e kemi pak të vështirë ta kultivojmë, sepse kërkon një terren tjetër për t'u promovuar. Mund të them që e gjej veten dhe te muzika jazz, blues, soul.

Pse zgjodhët të bashkëpunoni me Genën?

Në fakt, isha në kërkim për diçka të re. Gena gjithmonë ka qenë nga këngëtarët e mi të preferuar dhe mendova që mund të punoja më shumë kënaqësi me të, për ato çfarë unë kisha ndërmend të realizoja. Për këtë arsye isha unë që i kërkova Genës takim. Dhe ja ku jemi sot. Plot energji, dëshirën e mirë dhe pasionin për të bërë gjëra të bukura që dhe publiku që na ndjek në çdo koncert të kënaqet në maksimum me muzikën tonë! Sepse ky është dhe qëllimi ynë, të kënaqim publikun jo vetëm veten!

Ku synoni të arrini në të ardhmen?

Sigurisht që objektivat janë për të qenë lart e më lart, sepse ky është edhe synimi i çdo muzikanti. Pse jo, dhe në skena të mëdha botërore. Por një gjë është e sigurtë: Muzika do më shoqërojë gjithë jetën.

GENA

Përse zgjodhët të kishit bashkëpunim me Anestin?

Nesti është një muzikant tepër i talentuar me dëshirë të madhe për punën, por mbi të gjitha është një djalë i edukuar. Këto janë element tepër të rëndësishëm për një bashkëpunim.

A jeni duke punuar në ndonjë projekt të ri muzikor?

Po unë këto kohë jam duke punuar gjithë kohës në studio pasi po përgatis 3 projekte të reja. Të tria do të jenë duete. Njëra prej tyre, e cila del së shpejti, do të jetë me kolegen time, Greta Koçi. Të tjerat mbeten surprize, për t'u parë pasi nuk dua t'i zbuloj akoma.




Cili është bashkëpunimi me këngëtarë të tjerë që ju ka pëlqyer më tepër dhe ka pasur më sukses? Me kë do të preferonit të bashkëpunonit në të ardhmen?

Një bashkëpunim me këngëtarë që ka pasur shumë shumë sukses ka qenë me Nora Istrefin, "Le mamma". Në të ardhmen do preferoja të bashkëpunoja me shumë artistë sepse

bashkëpunimet gjithmonë kanë sukses dhe priten mjaft mirë nga publiku. Nuk do të veçoja dikë pasi ka shumë.

A keni pasur ndonjë "konflikt" apo incident me kolegët? Nëse po, cilin



INTERVISTA

ALFRED TREBICKA:

Nuk shkatërrohet teatri se është i vjetër! Po ju, zoti Rama, ç'plasje keni?

Fatmira Nikolli

Mendimi im është që ndërtimi, restaurimi apo bërja e ribërja e një institucioni siç është Teatri Kombëtar, apo edhe institucione të tjera si Teatri Kombëtar, të përmasave të tilla duhet të jenë plotësisht nisma dhe vepra të shtetit. Në këto nuk ka punë privati. Sepse bashkëpunimi i tillë është problematik. Në rastin konkret ky bashkëpunim do ketë këto pasoja. Nuk ka privat në botë që e bën për hobi një sipërmarrje të tillë. Po pra, po bashkëpunimi është i rrezikshëm në rastin konkret, sepse të merr territor". Aktori e regjisor, Alfred Trebicka ndalet gjatë tek çështja e Teatrit Kombëtar në një intervistë për "Gazeta Shqiptare". Duke nënvizuar se teatri është lënë qëllimisht të rrënohet, ai vë theksin te memoria në art, e memoria e qytetit dhe vlerat e godinës përtej infrastrukturës.

Nëse, thotë ai, do i shembim të gjitha se janë të vjetra, çfarë na mbetet. Duke mos pasur dyshime për korrupsion, Trebicka, thotë se nuk mund t'i kërkohej transparencë, trafikantëve të drogës. Për të, thelbi i asaj që po ndodh është përballja e komunitetit të artistëve me disa interesa të pastra biznesi. Ndaj, edhe në atë projekt që u prezantua, u pa që ishin kullat afër teatrit. "Nuk dua të gjykoj në bazë fjalësh po në bazë veprimesh konkrete. Veprimet konkrete që janë bërë deri tani sa i takon pjesës së artit e kulturës, e këtu kam parasysh fatin e kinemave, "17 Nëntori" e "Republika", nuk janë më.

Ndërkohë që në momentin kur është ndërhyrë është thënë që do bëhet një kinema me parametra evropianë", thotë Trebicka për "GSH".

- Që prej muajit shkurt një debat i madh ka lindur për çështjen e Teatrit Kombëtar. Nisi një ligjin e artit dhe më pas u bë një debat për teatrin. Si e keni ndjekur ju?

Natyrisht që unë jam pjesë e komunitetit teator. Pavarësisht se administrativisht nuk jam pjesë e teatrit, por përdërisa jam aktor dhe regjisor dhe në momentin që flasim jam në pikun e aktivitetit tim, sigurisht e kam ndjekur nga afër. Le të themi se kjo historia e teatrit është histori e vjetër. Është të paktën 20-vjeçare. Vitet e fundit ishte lënë në heshtje, jo se s'ka pas lëvizje nën të. Vetë nisma e ndërtimit të Turbinës ishte një paraprijë për të shkuar drejt kësaj, por se çfarë do të bëhej me teatrin nuk e dinte askush, nuk ishte ar-

Aktori i njohur: Të kërkohej transparencë te të korrumpuarit? Si t'u kërkohej transparencë trafikantëve



Roland Trebicka, gjatë bisedës për "GSH"

"Para se të shembnin kinematë, na thanë se do i bënin evropiane. Sot nuk kemi më kinema"

tikuluar gjë. Thjeshtë u tha që do të spositohej teatri nga ku është për të shkuar të Turbinës.

Por, nëse do bëhej rikonstrukcion, apo do të ndërtohej teatri i ri, nuk artikulohej asgjë. Sigurisht, thashetheme kishte plot.

Në shkurt ishin dy pika që dolën njëherësh, e para ishte ajo e shpërnguljes së teatrit të "Turbinës" dhe e dyta, qarkulloi dhe një ide që aty në Teatrin Kombëtar do të instalohet Teatri i Operës, çfarë, për mua e shumë të tjerë, nuk kish të sens, sepse ti heq një trupë dhe sjell një trupë tjetër. Më pas, ajo lloj infrastrukture që ka Teatri Kombëtar aktual, nuk ka lidhje fare me çfarë kërkon një Opera.

Unë e njoh operën dhe e di që Operat kanë stafe gjigante, orkestër, solistë, kor, balet, e të tjerë.

teatrin se do heqje konkurs e do zgjidhje projektin...

Po, ministria tha nuk ka projekt, por tha se do punojmë për të. Më pas doli që ishte një projekt i gatshëm dhe u bë një prezantim. Një prezantim që unë do thosha, që ishte jo ashtu siç duhej. Nuk dua të përdor terma të rëndë "diktatorial", "autoritar", etj.

- Ishit ftuar në atë prezantim? Jo. Dhe nuk është problemi me

- Megjithatë bëhet fjalë për pronë e trull publik, apo jo?

Sigurisht që është pronë publike e trull publik. Mua nuk më pëlqen që çështja kalohet sa nga Ministria e Kulturës te Bashkia e Tiranës.

Njëherë e merr topin bashkia e një herë ministria.

- Mbaje ministria ka qenë e papërfshirë aq sa nuk e dinte që kishte një projekt?

INTERESAT E BIZNESIT

Thelbi i asaj që po ndodh është përballja e komunitetit të artistëve me disa interesa të pastra biznesi. Edhe në atë projekt që u prezantua, u pa që ishin kullat të ndërtuara me radhë aty

ftuan a nuk më ftuan mua, sepse kishte edhe plot të tjerë që nuk u ftuan. Ishin kolegë që duhej të ishin ftuar. Është bërë si duket një seleksionim paraprak që disa nuk duhen thirrur. Fatmirësisht e ndoqa atë moment, atë prezantim në ERTV përmes telefonit. Ndoqa fjalën e kryeministrit dhe prezantimin e arkitektit, dhe po ashtu nëpër media të tjera dëgjova edhe fjalën e mjeshtrit Ndrenika.

- Si ju është dukur projekt?

Është e papranushme, e nuk ka sens një prezantim i tillë. Mbledh aty 200 njerëz nga komuniteti artistik, sepse kishte muzikantë, piktorë, regjisorë filmi dhe mos të krijosh asnjë lloj hapësire e mundësie për të bashkëbiseduar, domethënë, më duket pa sens. Dukej qartë që ishte marrë një vendim në vetvete që kjo do bëhet. Vetë fjala e kryeministrit filloi me frazën: teatri do shembet dhe do të ndërtohet një teatër i ri, sepse ai është i kalbur. Kuptohej që nuk ka asnjë hapësirë për komunikim. Ai thjesht tha vendimin e tij.

Nuk kishte vend as për argumente, për gjëra që janë kërkuar gjithmonë që në debatet e para që janë bërë në vitet 1998-2000. Është kërkuar që të diskutohet për këtë, është kërkuar të diskutohet se si duhet të jetë teatri.

Momenti që duhet prishur ky teatër a jo, vjen më pas, por kur e nis me frazën që ky do shembet, tërë të tjerat bien, se për çfarë do diskutojmë? Pse do prishet, është histori tjetër, që as aty nuk ka transparencë dhe nuk ka se si të ketë transparencë, se ka korrupsion. Është njësoj si të kërkohej transparencë me trafikantët e drogës, çfarë transparencë do t'i kërkohej atyre? Sa kilogram kokainë ke kaluar e sa ke ftuar? Çfarë t'u pyesësh?

Po. Mbaje, sepse projektin e shfaq kryeministri. Mënyra se si është bërë prezent ky projekt ka shumë pikëpyetje e lë shumë për të dyshuar në prapavijat që fshihen pas kësaj, e këtë e them duke mos dashur të përfshihem më thashetheme. Nuk dua të gjykoj në bazë fjalësh po në bazë veprimesh konkrete. Veprimet konkrete që janë bërë deri tani sa i takon pjesës së artit e kulturës, e këtu kam parasysh fatin e kinemave, "17 Nëntori" e "Republika", nuk janë më.

Ndërkohë që në momentin kur është ndërhyrë është thënë që do bëhet një kinema me parametra



Projekti i Teatrit Kombëtar



Teatri Kombëtar

evropianë. Por, sot nuk ka më kinema "17 Nëntori" as kinema "Republika". Duke pas parasysh se çfarë ndodhi me kinematë, ke frikë, sigurisht që ke frikë.

- Ndaj e vini në dyshim bashkëpunimin privat-publik?

Mendimi im është që ndërtimi, restaurimi apo bërja e ribërja e një institucioni siç është Teatri Kombëtar, apo edhe institucione të tjera si Teatri Kombëtar, të përmasave të tilla duhet të jenë plotësisht nisma dhe vepra të shtetit. Në këto nuk ka punë privati. Sepse bashkëpunimi i tillë është problematik. Në rastin konkret ky bashkëpunim do ketë këto pasoja. Nuk ka privat në botë që e bën për hobi një sipërmarrje të tillë.

- Në fakt, kryeministri u shpreh në prezantim që privati nuk do të falimentojë duke nënkuptuar bashkëpunimin me të.

Po pra, po bashkëpunimi është i rrezikshëm në rastin konkret, sepse të merr territor.

- Nga ana tjetër, godina në vetvete ka probleme?

Godina në vetvete ka shumë probleme në aspektin e amortizimit, por unë them që këto lloj objektivitet, këto lloj institucionesh, janë institucione që përveç memories arkitektonike kanë edhe një lloj memorie shpirtërore.

Nëse ti e shemb, e zhduk, ti fshin memorien. Në fund të fundit, historia e teatrit tonë fillon atje dhe deri më sot vjen atje. Nuk ka vend tjetër që të heqim këtë e t'i referohemi një tjetre. Në këtë sens ajo lë hapësirë për debat. Për këtë kanë reaguar nga specialistët e monumenteve të kulturës deri te Shoqata e Arkitektëve. Sepse këtu po ndodh një fenomen që për hir të marrëdhënies me biznesin e madh po shkatërrojnë çdo gjë. Ta shkatërrojmë këtë se është e vjetër,

ta shkatërrojmë këtë se është e vjetër, po çfarë na mbeti?

Unë me aq sa kam parë kur kam udhëtuar e nuk kam udhëtuar pak, bota i ruan këto objekte, i mirëmban një herë në gjashtë muaj ose njëherë në vit, sipas mundësive që ka. Ajo si godinë ka probleme, por ku është kleçka, apo thembra e Akilit? Aty ka vite të tëra që nuk investohet asgjë.

- Është lënë vetë në këtë gjendje?

Po. Është thënë që ka këto probleme, por nuk është bërë asnjë ndë-

H E LËNË QËLLIMISHT

Thuhet rëndom që Teatri Kombëtar nuk ka banjë, Teatri Kombëtar nuk ka kabina, nuk ka pasqyra, etj. Pse nuk i ka? Sepse është amortizuar godina? Jo. Ky teatri tjetër që është në krah, "Eksperimental", brenda mundësive e hapësirave që ka, ka krijuar një ambient që është komod e komfort për të punuar, që nga banjat, ambientet e punës, skena e të tjera me ato parametra që mundet, por ama është një vend komod për të punuar. Është një vend ku nuk shkon me stres se "ku do shkoj në tualet?".

H TRANSPARENCA E QEVERISË

Pse do priset, është histori tjetër, që as aty nuk ka transparencë dhe nuk ka se si të ketë transparencë, se ka korrupsion. Është njësoj si të kërkojsh transparencë me trafikantët e drogës, çfarë transparencë do t'u kërkojsh atyre?

rhyrje. Dakord ka rreziqe, eja e ta rregullojmë. Por nuk u bë asgjë, as në infrastrukturën e brendshme të teatrit. Thuhet rëndom që Teatri Kombëtar nuk ka banjë, Teatri Kombëtar nuk ka kabina, nuk ka pasqyra, etj. Pse nuk i ka? Sepse është amortizuar godina? Jo. Ky teatri tjetër që është në krah, "Eksperimental", brenda mundësive e hapësirave që ka, ka krijuar një ambient që është komod e komfort për të punuar, që nga banjat, ambientet e punës, skena e të tjera me ato parametra që mundet, por ama është një vend komod për të punuar. Është një vend ku nuk shkon me stres se "ku do shkoj në tualet?". Imagjino që aktorët e TK-së vijnë e përdorin banjën e Teatrit Eksperimental. Por, kjo nuk ka të bëjë me amortizimin e godinës. Unë kam bindjen që është më tej.

- Pra, është lënë qëllimisht?

Sigurisht që po. Është lënë të degradojë edhe si ndërtesë, edhe si infrastrukturë e brendshme dhe ironia e tërë kësaj është se në këto vitet e fundit numri i spektatorëve është rritur. Pra, në një anë rritet numri i spektatorëve, e në anën tjetër, teatri duhet shembur. Kjo historia që do digjet e do bjerë është histori e vjetër, i ka dalë boja. Aty janë bërë dhe prova, në rast rënies së zjarrit, nuk ka pas probleme. Janë bërë prova që në kohën që ka qenë gjallë i ndjeri Agim Qirjaqi.

- **Meqë jemi te raporti i shtetit me artin, doja t'ju pyesja për rishikimin e ligjit të artit. Një prej neneve u kërkon artistëve që për çdo projekt, edhe për ato private me financime private të kërkojnë një leje në Ministrinë e Kulturës. Duket, se ndërsa Tirana diskuton për teatrin, ligji po miratohet. Sa kontrollues është ky nen?**

Ai është thjeshtë e pastër, centralizim. Që çdo vido e çdo leje duhet të jepet nga qeveria, nga Ministria e Kulturës për çdo projekt, edhe për një projekt privat që për mua është një handicap i madh. Në thelbin e vet, është thjeshtë centralizim.

- Një ndërhyrje e tillë në ligjin e artit bëhet ndërkohë kur për statusin e artistin nuk u gjet kohë kurrë?

Për statusin e artistit nuk u vjen kurrë zëri. Ne e kemi artikulluar dhe e kemi kërkuar. Madje e kemi artikulluar edhe në shfaqje. Një kolegu im, thoshte vazhdimisht, në çdo shfaqje "na jepni more statusin, se nuk kemi status. Edhe bojaxhiu ka status, edhe pastresja ka status vetëm artistët nuk kanë status". Për mua ka një moment shumë të rëndësishëm që është momenti i vullnetit politik për ta bërë këtë gjë. Nuk është puna vetëm të ligji e vetëm të statusi, puna është të mënyra se si janë trajtuar njerëzit e teatrit e

Operës. Heqja e shpërblimit artistik për artistët është shumë e rëndë për mua. Është të funksionosh keq. Që në momentin që kryeministri thotë, nuk e kuptoj çfarë kërkojnë këta.

- Kryeministri tha: "nuk e kuptoj ç'plasje kanë". Në fakt, duke e cituar atë, "ç'plasje keni ju artistët"?

Kjo shprehja ç'plasje kanë... Nuk mund të komunikohet kështu, në këtë lloj mënyre, e në këtë lloj forme me "ç'plasje keni". Se pastaj mund të të vijë përgjigja. Komuniteti i artistëve është aq i aftë, sa mund të të vijë edhe ty një përgjigje: "po ti, ç'plasje ke, që do ta shkatërrosh këtë teatër?"

- A mundet komuniteti i artistëve të mblidhet, bashkë, për të kundërshtuar, qoftë fjalorin, qoftë sjelljen, qoftë projektin, qoftë ligjin?

Ne do bëjmë tonën. Do të bëjmë rezistencën tonë ndaj kësaj gjëje. Dhe unë jam optimist i dëshpëruar në këtë pikë, por optimist jam që do të ketë reagim, domethënë do ketë reagim pozitiv edhe nga ana e pushtetit. Kjo, sepse nuk bëhet fjalë për një gjë minorene, por bëhet fjalë për një institucion kombëtar, bëhet fjalë për histori, bëhet fjalë për memorie, bëhet fjalë për një pjesë shpirtërore të Tiranës edhe më gjerë. Nuk është thjeshtë që po shembim një gërmadhe, një karantinë aty. Po të udhëtosh në Shqipëri ka gërmadha e karakatina sa të duash që janë lënë ashtu dhe as që i bie mend njeriu për to. Në rastin konkret, nuk bëhet fjalë për karakatina e për gërmadha. Në rastin konkret bëhet fjalë për territor në zemër të Tiranës, dhe që është një territor i lakmueshëm për këdo që do të bëjë biznesin e vet. Kjo është e evidente. Nëse ne nuk arrijmë të kuptojmë e të perceptojmë këtë gjë, jemi vërtetë miopë domethënë.

Jo vetëm komuniteti teator; por të gjithë qytetarët e Tiranës dhe të Shqipërisë, duhet të ndërjegjësohen për këtë gjë. Që këtu, thelbi i asaj që po ndodh është përballja e komunitetit të artistëve me disa interesa të pastra biznesi. Edhe në atë projekt që u prezantua, u pa që ishin kullat të ndërhuara me radhë aty. Probleme teatri ka sa të duash, po të futem të flas se si funksionon teatri, atëherë unë nuk mbaroj. Çdo gjë që bëhet serviret si kryepër, sikur u trondit bota e Evropa nga kjo shfaqja dhe kur shkon në sallë sheh se treçerëku i sallës bosh. Por, problemi jetik sot, është mbijetesa e teatrit. Në këtë shfaqjen e fundit që vura në skenë, më thotë partneri im në dialog: "Pse, rrallë herë kemi qenë ne si komb në zgrip të historisë?" "Dhe unë i them, shpesh kemi qenë, ne jemi në zgrip akoma". Megjithatë unë jam optimist i dëshpëruar në këtë pikë. Them se do të gjendet një mënyrë.



Opinion i Ditës

Partia Demokratike është prona e përbashkët, publike

Nga Valbona Mezini

(vlon nga faqja 1)

... demokratët i shqetëson, a çfarë po ndodh me grupin prej 5 vetësh, që kryesia miratoi për ndryshimet statutore?

Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Partisë demokratike është një detyrë statutore e shkruar të zezë mbi të bardhë në statutin e partisë, se Këshilli Kombëtar mbledhet të paktën një herë mes dy kuvendeve.

Shumë dallgë po kalon parti, e për Këshillin Kombëtar organi më i rëndësishëm i partisë, që zgjidhet me delegim vote nga anëtarësia demokratike, nuk i shkon mendja lidhshimit ta mbledhë.

Duhet thënë një e vërtetë, që, në fakt, fshehja e saj nuk i shërben askujt, përkundrazi fshehja e saj demokratëve u prish punë, që Këshilli Kombëtar të cilin ata e votuan në 27 shtator 2014, nuk po kujtohet askush ta mbledhë, derisa po i afrohet koha t'i mbarojnë kompetencat.

Fakti që K.K nuk u mblodh asnjëherë në 4 vite në Partinë Demokratike, është një shkelje e kushtetutës së partisë STATUTIT, dhe një mesazh se në ardhshim ndonjëherë në pushtet nuk na interesojnë institucionet dhe nuk i njohim ligjet, dhe të kujton sjelljen e "fëmijës naiv", topi është i imi, fusha është e imja, porta po e imja, golin e bëj vetë.

Në mbledhjen e fundit të kryesisë u mor vendim dhe u miratua ngritja e një grupi pune për ndryshimet statutore.

Asnjë lajm se çfarë po ndodh me grupin e punës, çfarë po rezulton nga puna e tij?

Pse kaq errësirë për një nga proceset më të rëndësishme në parti?

Akoma e paqartë nëse në kryesi u vendos për një datë kur do të jetë kuvendi i madh i demokratëve?

Ky kuvend do të miratojë ndryshime statutore apo ndryshime politike?

Nxitimi për të mbyllur pa një diskutim të gjatë e të hapur në kryesi apo Këshill Kombëtar, të ndryshimeve statutore dhe jo vetëm, është nxitim për të errur qëllime që nuk kanë të bëjnë me transparencën dhe ndershmërinë që, në fakt, do të donte t'i kishte hije një procesi të tillë.

As data 28 prill, e cila kaloi si hedhje ideje dhe jo votim i mirëfillt në kryesi, nuk është e qartë nga kryesia, se në të vërtetë, çfarë nguti ka për të kryer kaq shpejt një proces kuvendimi që s'po ka transparencë dhe përkushtim. Kuvend i ri për një parti të re, apo kuvend i ri për përmirësime të reja statutore? Kjo është çështja që demokratët e parritur ende politikisht nuk po dinë ta ndajnë.

Pa dashje po i shërbejnë rehatit



të lidhshimit për të mbyllur hesapet shpejt dhe jo forcimit të strukturave të shëndetshme, dhe, në fakt, ka gjasa t'i kenë shërbyer dëmtimit të demokracisë së brendshme dhe institucioneve në të ardhmen.

A nuk është një shkelje tjetër e statutit nëse dikush brenda partisë, do vendosë tinës një datë pa diskutime dhe dëgjuar ide?

Puna e thirrjes së një kuvendi duhet përqendruar me disa mbledhje në kryesi, pa kurrfarë nxitimi, sepse tek e fundit në opozitë kemi kohë për ndryshime cilësore.

Por a kemi dëshirë? Nuk mund të biem në grackën e asaj që mund të na rezultojë si pabesia e fundit për Partinë Demokratike.

Procesi i tillë do t'i ngjasonte skenarit të privatizimit në një dorë të partisë, me struktura fiktive, që heshtin për logarit të pazare personale.

Në një kohë kur do të kishin misionin e argumentimit të mendimit ndryshe po të ish nevoja, brenda strukturave më të larta vendimmarrëse, duke dhënë garancinë se nga brenda po ndërto-

het demokracia, dhe po pengohet përdorimi lehtësisht nga klanet nepotike dhe klienteliste të kujtdo lidhshimit, që ndihmuar nga një shpurë servilësh, njerëz që kanë veç hallin e karrierës së tyre, pa hezitim do të duan ta vënë veten në shërbim të vendimmarrjeve autokratike, dhe nga këta ka çdo parti me shumicë.

Por Partia Demokratike duhet të ngrihet mbi këtë ngrehinë që po i bën vetes.

Kjo është një sfidë për partinë në të ardhmen e afërt.

Sfida e kujtdo lidhshimit brenda çdo partie, është të organizojë vendimmarrje kolegjiale duke respektuar mendimin ndryshe, duke dhënë besim nëpërmjet organizimit statutor dhe respektimit të tij, si libri supreme mbi çdo dëshirë a oreks personal, qoftë ky edhe kryetar partie.

Vetëm kështu do të ndërtohet meritokracia dhe do të ngjallet shpresa e munguar se Partia Demokratike bashkohet.

Kriza sot në Partinë Demokratike u shkaktoi si rezultat i injorimit të meritokracisë, kontributeve dhe shkeljeve statutore që

Nxitimi për të mbyllur pa një diskutim të gjatë e të hapur në kryesi apo Këshill Kombëtar, të ndryshimeve statutore dhe jo vetëm, është nxitim për të errur qëllime që nuk kanë të bëjnë me transparencën dhe ndershmërinë që, në fakt, do të donte t'i kishte hije një procesi të tillë.

lidhshipi bëri.

Këtu ka vend sa të duash për tu dhënë demokratëve prova se partinë nuk e konsideron pronë me hipotekë dhe me të nuk mund të bësh pazar as me kundërshtarin as me koniunktura të huaja partnere a jo, që ta zbardhin faqen në kohë fushatash apo më keq akoma ta nxijnë faqen, edhe në ditën me diell, siç ndodhi javë më parë.

Vendimmarrjet duhet të jenë kolegjiale të paraprirra nga procese të gjata diskutative, që garantojnë transparencë dhe nuk shkaktojnë mbajtje përgjegjësie. Përgjegjësi deri tani nuk po mban askush.

Kjo është e vërteta, e cila kërkim besim për t'u rikuperuar dhe jo shkelje të mëtejshme të procesit të forcimit të partisë.

Ndaj edhe do të ngre një pyetje. Çfarë po bën grupi i punës që miratoi kryesia e partisë në 8 mars?

Këto duhej të ishin lajmet që media do të shpërndanin me zhvillimet brenda PD-së, por fatkeqësisht heshje totale dhe errësirë.

Ndryshimet statutore të propo-

zuara, mbase do të kenë nevojë të diskutohen edhe në një tjetër mbledhje qoftë Këshilli Kombëtar apo kryesia, sepse statuti i partisë është as më pak e as më shumë kushtetuta që garanton demokracinë brenda Partisë.

Përmbajta e fjalës demokraci për të cilën Partia Demokratike e ka në qëllimin e krijimit të saj, është shkelur disa herë. Në mënyrë të qëllimshme apo jo këtë do ta dëshmojë koha.

Nëse nxitohet drejt thirrjes së kuvendit duke anashkaluar çfarë kryesia miratoi së fundmi, një transparencë e plotë për punën e grupit që u ngrit për statutin e ri dhe se cilat janë ato, atëherë shqiptarëve nuk u mbetet zgjidhje tjetër, veç t'i tregojnë vendin lidhshimit në emër të së ardhmes, sepse Partia Demokratike për ata që nuk e dinë është pasuri kombëtare që u përket të gjithëve, pasi votëbesohet mbi bazë besimi nga shqiptarët për të përdorur paratë e taksapaguesve, për të ndërtuar të ardhmen tonë.

Përmbajta e fjalës demokraci për të cilën Partia Demokratike e ka në qëllimin e krijimit të saj, është shkelur disa herë. Në mënyrë të qëllimshme apo jo këtë do ta dëshmojë koha.

Opinioni i Ditës

Shqipëria, ç'është dhe ç'do të jetë Saranda dhe të huajt për ne

Nga Raimonda Shundi

(vijon nga faqja 1)

... pagesat e ulëta të tavolinave të shijshme shqiptare"; ky është konstatimi i vazhdueshëm i një grupi Valdostan në Sarandë dhe Tiranë.

"Si ka mundësi që në gjithë këtë peizazh që të kap syri ju nuk keni mundur të ndërtoni një aeroport gjigand apo një linjë treni?", më pyesin vazhdimisht miqtë e mi nga Aosta, Giulia, Paolo dhe Carlo, të cilët erdhën në Tiranë në qëllimin e blerjes së një apartamenti në zemër të Sarandës. Përpiqem t'i sqaroj situatën e komplikuar në të cilën ne ndodhemi. Për të ndërtuar gjithë këto, na duhet kjo, kjo, edhe kjo.... por ne jemi të kushtëzuar me marrjen e kësaj, apo asaj, pasi fondet duhen çuar këtu apo aty-këtu... si rrjedhim kriza nuk na le asnjë hapësirë të lirë që ne të mundemi të bëjmë këtë apo atë investim gjigand. "Por kjo ju sjell para, ju lidh shpejt me veriun apo jugun e Shqipërisë, ju rrit mirëqenien e natyrisht ju bën më të ekspozuar" e të vizituar. Dhe unë nis të rishpjegoj se ne kemi në këtë fazë këtë apo atë prioritet, ndërkohë që Paolo ndal makinën dhe thotë "Po këto?!" (duke treguar nga shishet plastike të kudogjendura në lëndinat e anës së rrugës) "Pse janë këto? Pse të hidhen ndërkohë që mund të mos lëshohen si t'u vijë banorëve e të mblihen në vendin e caktuar duke bërë që edhe kafshët shtëpiake të kullosin shëndetshëm? Pse nuk shoh plantacione me rrush për të zhvilluar ekonominë private të biznesit të verës apo derivateve të tij?!" Pse, pse, pse...

Jetojmë kohë ku reklamati e fryra dhe nacionalizmi televiziv na bëjnë të shohim kronika hiperbolike të bizneseve private që kanë nisur të lulëzojnë duke u sforcuar individualisht t'ia dalin në këtë terren aspak solidar. Shohim vendas apo të huaj se si ia dalin, mbi-jetojnë, duke pasqyruar vetëm finalizimin e punës së tyre (të cilën ne e konsumojmë çdo ditë në tavolinat tona), emisione pa fund për sukseset e prodhimit shqiptar. Por a mjafton vetëm ky realitet karikues?! Pse duhet të përballemi ende me natyrën tonë, e cila po asfiksohet nën hijen e mbeturinave, mbetjeve, djerrizimit apo më keq akoma, keqpërdorimit e dhuratës natyrë që na takon prej lindjes? Kaq pyetje dhe asnjë përgjigje dëshiruese. Sapo kalon kufirin përballëmi me realitetet të trishita për Shqipërinë tonë: rrugë të gjera, sisteme sinjalistike, pyje të kurrara, turizëm i organizuar dhe shtet i cili di të menaxhojë resurset e veta natyrore. Matematikë e thjeshtë, por ne na shkojnë në xhepat e gabuar. Një shprehje e jona thotë "si është oborri është shtëpia, si është e ëma dhe e bija". Këtë panë miqtë e mi nga Aosta dhe natyrshëm thanë se ne jemi bijtë e një nëne jo të kujdesshme për atë çka posedon. Natyrisht që kemi kaq shumë përmbetje, erozione apo djegie masive të pyjeve dhe kullotave që herë-herë janë të qëllimshme, por qëllimshmëria e



akteve të fundit lidhet dhe është rrjedhojë e papërgjegjshmërisë sociale. Papërgjegjshmëria ndaj natyrës së begatë që na e ka dhuruar zoti, shkon deri në ekstrem, po t'i referohemi papërgjegjshmërisë dhe sjelljes, marrëdhënies dhe përkujdesit ndaj miqve më të mirë të njeriut, siç janë qentë dhe macet. Bashkëjetesë aspak e bukur dhe mikpritëse me ta. Siç shohim plehrat, ndërtesat e dhunuara, hasim edhe mungesë respekti për qentë dhe kafshët fat-

keqe. Vrazhdësitë traumatike pikëllojnë ditët tona kur përpiqemi të shëtisim në rrugët e qytetit tonë. Mungesa e këtij raporti njeri-kafshë-ambient, është normaliteti më i trishitë, të cilët të huajt, por edhe ne po të jemi të vëmendshëm, e shohim. Pse kaq shumë egërsi në Shqipërinë tonë të vogël?? Pse dominon jo-harmonia në vend të ylberit të paqes dhe diellit të mendjes së hapur? Deri kur kjo panoramë do të na vrasë sytë, ne dhe miqve tanë të huaj, të cilët vijnë për të bash-

këjetuar, punuar apo projektuar vazhdimësinë në këto 28 mijë kilometra katrorë? Dyanësia e shtëpive të luksit shpejt përballë me kasollet ndërtuar keqas gjatë gjithë rrugëtimit tonë. A ndjehen këshu edhe politikëbërësit tanë teksa shoqërohen nga diplomatët të huaj dhe shohin se sa shumë është "zhvilluar" vendi aspirues për në BE?! Dikush thotë se politika është pjesë e këtij realiteti, pra si janë këto "shtëpi skelet" (shprehja e vazhdueshme e Gullia) janë edhe ata. Por unë e dua vendin tim dinjitoz, siç dua dinjitetin tim, dinjitetin e fëmijëve, dinjitetin e fqinjëve dhe dinjitetin e globit. Kur do të vijë dita që aeroplani nga lart të pasqyrojë një panoramë optimiste ku gjelbërimi (dhe jo ai për të cilin keqkomentohemi) të na sjellë shpresë, e kur shumë miq dashamirës të jetojnë duke ndarë kulturat e përbashkëta njerëzore qytetësisht? Dhe kur do të vijë ajo ditë kur fshatari apo qoftë edhe qytetari kryeqytetas të kuptojë rëndësinë e hedhjes në kosh të mbeturinave dhe riciklimit të tyre?! Dikur do të vijë. Do të vijë atëherë kur ne si shqiptarë do të ndërjegjësohemi që të qenit shqiptar është një vlerë, është një privilegj dhe nder. (Sa keq ta mbyllësh materialin me këtë shpresë!)

Jetojmë kohë ku reklamati e fryra dhe nacionalizmi televiziv na bëjnë të shohim kronika hiperbolike të bizneseve private që kanë nisur të lulëzojnë duke u sforcuar individualisht t'ia dalin në këtë terren aspak solidar. Shohim vendas apo të huaj se si ia dalin, mbi-jetojnë, duke pasqyruar vetëm finalizimin e punës së tyre (të cilën ne e konsumojmë çdo ditë në tavolinat tona), emisione pa fund për sukseset e prodhimit shqiptar. Por a mjafton vetëm ky realitet karikues?! Pse duhet të përballemi ende me natyrën tonë, e cila po asfiksohet nën hijen e mbeturinave, mbetjeve, djerrizimit apo më keq akoma, keqpërdorimit e dhuratës natyrë që na takon prej lindjes?

HOROSKOPI

DASHI

Edhe pse duhet të qortoni dikë që nuk është shumë i vëmendshëm, tregohuni i qetë. Vëreni veten gjithmonë në pozicionin e tjetrit, përpara se ta kritikoni. Në çastin më të posaçëm do të dini gjithmonë t'i rimerrni në dorë frerët e situatës.

DEMI

Ditën e sotme do t'ju mungojë shpejtësia për të tejkaluar kundërshtarit tuaj si edhe për të fituar kështu një avantazh të konsiderueshëm ndaj tij! Do të jetë një përballje e fuqishme, por ajo që është e sigurt është se nuk do ta shisni kursesi lirë lëkurën tuaj.

BINJAKET

Do të prisni me frikë ardhjen e një mesazhi të rëndësishëm, që po ju mban nën tension. Hiqeni këtë mendim, nëse nuk doni që të zmadhoni ankthin. Ndoshta adresa ishte gabim ose dërguesi e ka hartuar fare. Por ju nuk i duroni dot pakujdesitë.

GAFORJA

Më shumë se për punën dhe afatet që mbarojnë, po mendoni sesi të argetoheni me ndonjë rreng të bukur që t'i kurdnsni mikut tuaj më të mirë! Në fillim puna, pastaj kënaqësia, ndryshe do të hani një të ulëritur jo shumë të këndshme.

LUANI

Para se të futni dorën në kuletë, bëni disa llogari, për të kuptuar se cili shpenzim i tepërt, që nuk ishte i llogaritur mund ta merrni në konsideratë. Nëse mendoni se mund t'ia dilni pa pasur një gjë të caktuar për të pasur diçka tjerë, vetëm ju e keni në dorë të zgjidhni.

VIRGJERESHA

Shumë kërkesa që nuk presin rrezikojnë t'ju vënë për poshtë. Keni dëshirë t'ua përmbushni dëshirat të tjerëve, por nuk mund të jeni i pranishëm me të gjithë! Gjenerali ekuilibrit duhur, duke u udhëhequr nga instinkti dhe nga biondënsi i thjeshtë.

PESHORJA

Pasiguri të vogla për të shprehur emocionet tuaja të brendshme mund ta bëjnë të vështirë që partneri i jetës t'ju kuptojë. Dukeni i përumbur, edhe pse në të vërtetë jeni duke pleqëruar thellësisht mbi një çështje që ju shqetëson.

AKREPI

Nëse është e vërtetë se mjafton të duash për ta bërë diçka, është, gjithashtu, e drejtë të thuash se të vazhdoni në drejtimin e gabuar, ju bën të humbni shumë nga koha tuaj e vyer. Mund të keni nevojë për një ndihmesë. Por nuk duhet ta pranoi nëse nuk është në avantazhin tuaj.

SHIGJETARI

Jeni shumë i aftë për të çuar përpara negociatat rraskapitëse. Por në fund edhe ju mund të ndiheni të shtypur nën ngarkesën e tepërt të përgjegjësisë. Duhet të mësoni të ndani dhe të delegoni punët. Ju nuk mund të mbani gjithmonë gjithçka mbi supet.

BRICJAPI

Këtë ditë mendimet tuaja do të jenë më pak të turbullta dhe mund të ndriçoni të gjitha zonat e errëta që ju trembin. Në fund të fundit, kjo është edhe për të mirën tuaj. Nëse partneri ju kërkoi pak kohë, jeni dispozicion menjëherë dhe mos bëni fjalë.

UJORI

Të dish të zgjedhësh për më të mirën nuk është e lehtë, kur bëhet fjalë të mendoni si për mirëqenien tuaj ashtu edhe për atë të tjerëve. Njerëzit i besojnë instinktit tuaj dhe kjo ju pëlqen. Por lind pyetja nëse ju i zini besë ap

PESHQIT

Bashkëpërimi i planetëve do t'ju favorizojë lëvizjet, qoftshin këto si për kënaqësi ashtu edhe për punë. Negociatat dhe puna do të ecin vaj. Priteni pozitivisht risinë. Edhe pse gjërat nuk ju dukën shumë interesante, shumë shpejt ato do të jenë!

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me 4900 përfituesit

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shqëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

KOMPENSIMI FIZIK

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të

kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondi i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind më



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e

mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti për diferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës.

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqjeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi

fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesi a	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	---------	----------------------------	-----------

(Vijon nga numri i djeshëm)

Tiranë	BAKUSHE TABAKU			22,099,770
Tiranë	IKBALE KOMTI			55,249,425
Tiranë	NERIMAN LLESHI			14,800,149
Berat	Mane Qama			-
Berat	Orhan Bajraktari			217,880
Berat	Hajri Sinani			13,633
Berat	Shefqet Naço			127,288
Korçë	Ismail Cabej			
Korçë	Skënder Cabej			EZAURUAR
Korçë	Teki Cabej			54,816
Korçë	Donike Ismail Jaupi (Orhanasi)			321,600
Korçë	Ferdane Kraja, Xhensila Kraja			
Korçë	Thoma Perdihuku			88,750
Lezhë	Errok Gjet Paçuku			
Shkodër	Adem Jemin Hasani			150,000
Shkodër	Xhemal Selman Lluka			144,917
Tiranë				EZAURUAR
Vlorë	Vasil Mako			
Vlorë	Vangjel Nika			26,400
Berat	Belul Çeta			-
Berat	Fasho Hysi			799,147
Shkodër	Beqir Sokoli			4,561,896
Shkodër	Vitore Dema			
Shkodër	Zef Franja			
Shkodër	Qemal Dragovoja			
Tiranë	SKENDER MUHARREM HUTA			3,134,149
Tiranë	BAJRAN SHAMKU			2,393,532
Tiranë	RAHMILJE ÇASHKU			7,902,342
Tiranë	SHABAN KAÇERRI			281,270
Tiranë	ISMAIL FAGU			
Vlorë	Fatmir Hodaj			
Vlorë	Burbuqe Dervishi			
Vlorë	Reuf Dauti			
Vlorë	Yzeir Tushe			
Korçë	Margarita Progri			
Durrës	Jorgji Korra			


Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesi a	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	---------	----------------------------	-----------

Durrës	Bege Troplini			
Elbasan	PELLUMB HOXHA			5,117,802
Elbasan	SEJAT KISHTA			1,794,003
Elbasan	SHINAFRED SADIKU			733,910
Elbasan	IDRIZ XHAFFERI			394,477
Elbasan	SAMIT DUZHA			1,187,304
Elbasan	Zeni Braçi			3,261,824
Elbasan	XHEVIT DUZHA			326,182
Elbasan	VEHBI MYFTAJ			
Korçë	Fuat Purbollari			EZAURUAR
Korçë	Arefi Elmasllari, Farije Elmazllari, Nafije El			EZAURUAR
Korçë				
Korçë	Ylli Simixhiu			126,720
Korçë	Përparim Seiftari			2,276,547
Tiranë	BASHKIM BEKTESHI			
Tiranë	IBRAHIM XHAMETA			
Tiranë	IBRAHIM XHAMETA			EZAURUAR
Tiranë	IBRAHIM XHAMETA			EZAURUAR
Tiranë	IBRAHIM XHAMETA			EZAURUAR
Tiranë	LUMTURI BATALLI			
Durrës	Apollon Dilo			
Durrës	Dashamir Murati			
Durrës	Ismail Menekshi			
Durrës				
Elbasan	FATMIR KACADEJ			EZAURUAR
Elbasan	ISAK BICI			1,659,320
Elbasan	ABEDIN DERVISHI			-
Korçë	Myze Manka			362,800
Korçë	Rushan Brahimllari			
Korçë	Nevruz Stermoll			63,070
Korçë	Llazi Mele			629,000
Korçë	Selim Hoxha			
Korçë	Lirika Gjika			
Korçë	Azbi Agoll			319,296
Lezhë	Preng Ded Dedaj(Loci)			180,000
Shkodër	Behije Suma			
Shkodër	Valeria Sheldija			4,367,250
Shkodër	Fitnet Mandija			
Shkodër	Aleme Sekniqi			

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesi a	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	---------	----------------------------	-----------

Shkodër	Adnan Agai			EZAURUAR
Shkodër	Vehbi Trashani			4,950,315
Shkodër	Rasim Hamit Berdica			14,423,140
Shkodër	Suzana Rexhep Meta			1,100,070
Tiranë	ISUF, HAXHI KOKOSHI			
Tiranë	Jorgji Teli			1,115,280
Tiranë	ELEONORA ISAKU			151,028
Tiranë	QERIME DIMNI			
Tiranë	HASAN GORA			10,823,693
Tiranë	BESNIK TETA			15,335,901
Tiranë	BESNIK FAJA			13,125,924
Tiranë	ISMAIL BARONI (BAJRAMI)			
Tiranë	SELIM LULI			
Tiranë	SELIM LULI			EZAURUAR
Tiranë	SELIM LULI			376,320
Tiranë	MEHMET DAJA			2,732,335
Vlorë	Agim Toro			
Elbasan	QAMIL ÇIFTJA			1,311,936
Berat	MEDI MYRTO LULAJ			17,343
Shkodër	Violeta Hoti			172,010
Vlorë	Vasil Duka			
Vlorë	Skendo Ramaj			
Durrës	Kurt Kamberi			6,819,138
Vlorë	Shyqyri Radhima			
Durrës	Mitrush Minia			
Vlorë				
Vlorë	Trashigimtaret Kojdheh			
Durrës	Luigj Vlashi			
Durrës	Njazi Beshiri			
Durrës	Xhelal Stermasi			
Tiranë	SULEJMAN HAZIZ ISMAILI			EZAURUAR
Elbasan	QANI NASUFI			1,588,508
Elbasan	Avni Kllogjeri			1,106,574
Elbasan	RAKIP KLOGJERI			4,281,144
Elbasan	Fisnik Kllogjeri			705,369
Elbasan	XHAFFER CANI			1,223,184
Elbasan	ALUSH HIDA			
Elbasan	MUHAREM MURASHI			489,274
Gjirokastër	Ylli Dode			684,983
Gjirokastër	Stavro Vangjeli			

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. E famshja Curie
- 5. Më e mira është rekord.
- 9. Inicialet e Kurosawa-s.
- 11. Është edhe ai i mendimeve.
- 12. Një mund të jetë zemërkau
- 13. Është dollapi.
- 14. Gjysmë mizoze.
- 15. Fillojnë sefte.
- 16. Ishte shkollë e Aristotelit.
- 20. Ndodh në kufij.
- 22. Bëhen me ambalazh.
- 23. Janë idhnakë.
- 25. Fillojnë titujt.
- 26. Do të bëhen pemë.
- 27. Ashtu si jeton heremit.
- 29. Është dhomë e lartë.
- 30. Janë spanjollët dhe portugezët.
- 32. Ishte filozofi që preu damarët.

- 34. Janë gjuhë...veshi.
- 35. Musketierët e Dumas.
- 36. Lila këngëtare.
- 37. Kufizojnë takimet.
- 38. Ullmann aktore.
- 39. Mbledh baskët separatistë.
- 40. Fillojnë kapjen.
- 41. Inicialet e Delon.
- 43. Lumi i Bernës.
- 44. Është numri të parit.
- 45. Një thirrje me emra.

VERTIKAL

- 1. Farrow aktore.
- 2. Me Romeo në makinë.
- 3. Rolet pa zë.
- 4. Kufij itinerari.
- 5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
- 6. Në mes të dhomës.
- 7. Një tabu islamike.
- 8. Mbyllin fushatat.
- 10. Janë festime
- 11. Lehar kompozitor.
- 12. Janë shtyllat për vela
- 14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
- 16. Duhet fituar me djesër.
- 17. Piktura pa kura.
- 18. Janë dokumente partie.
- 19. Në fund të vitit.
- 21. Farkëtoi armët e Akilit.
- 22. Një është për kërcim.
- 24. Athinaja e romakëve.
- 25. Janë kapriçiot.
- 27. Një tis mjegulle.
- 28. Kërcimi i Fred Astaire.
- 31. Edwards regjisor.
- 33. Parker regjisor.
- 38. Luan në kufij
- 39. Inicialet e Rohmer.
- 42. Fillojnë detyrën.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Lama i Tibetit.
- 5. Janë vendet e lira
- 11. Martin i Jack London.
- 13. Comaneci e famshme e gjimnastikës.
- 15. Ekstremit në sirtar.
- 16. Janë princër arabë.
- 17. Një treshe në skenë.
- 19. Një provë inteligjence.
- 21. Gjysmë tatimi.
- 23. Gjysmë eolike.
- 24. Ekstremit në studim.
- 25. Bëjnë stil të lirë
- 28. Ndalo në kufij
- 29. Kaluar në krye.
- 30. Një tragjedi... e Dreiser.
- 33. Grier aktore.
- 34. Dashi kur mungon ai
- 36. Është zanore në filma
- 38. Kufizohet në kufij
- 39. Ente Civile Europiane.

VERTIKAL


- 1. Është halli.
- 2. Fillon me rruga...
- 3. Kastile janë në fund
- 4. Janë në skaje
- 6. Është vendi aderues
- 7. Ka kryeqytet Doha.
- 8. Inicialet e Daudet.
- 9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
- 10. Igli te Lazio.
- 12. Janë zjarrvënës.
- 14. Flanders e Defoe.
- 18. Shkroi Rinoceronti.
- 20. Ekstremit në slām.
- 22. Janë trille.
- 25. Qytet italian.
- 26. Jepen për hartim.
- 27. Fillojë takimet.
- 29. Kufizojnë kënde.
- 31. Janë vendet e para.
- 32. Një greminë.
- 35. Është llogarin që qërohet.
- 36. Ndiquen me ilaçe.
- 37. Massari aktore italiane.
- 38. Është melodramë.
- 40. Një thirrje e dëshiruar nga maja e direkut.
- 41. Kush ka... fërgëllon.
- 44. Një i fundit mbi të gjithë.
- 45. Një pjesë e satelitëve.
- 47. Në krye të njerëzve.
- 48. Sikur janë në krye.
- 49. Inicialet e Taylor që qe aktore..



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



SUDOKU

		2	9			8		3
9	5	4					1	
			2	1				7
	9			6	3		7	8
5			4		8			1
4	3		7	9				2
7				3	9			
	1					7	6	5
8		6			5	2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	6	2	7	8	4	3	1	9
4	9	1	2	5	3	8	7	6
8	7	3	9	6	1	4	5	2
2	3	6	8	1	9	7	4	5
7	8	4	6	3	5	9	2	1
1	5	9	4	2	7	6	3	8
9	4	5	1	7	6	2	8	3
3	2	7	5	9	8	1	6	4
6	1	8	3	4	2	5	9	7

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A
L	A	N	A	F	E	A	R	I	S			
A	L	N	E	N	A	P	T	O	P			
N	E	G	E	R	S	I	R	A	T	B	I	
S	A	S	M	O	D	E	U	M	I	R		
I	A	M	T	A	R	A	F	F	A	R	A	
M	R	O	N	I	N	A	R	I	E	T		
H	A	B	E	R	I	O	M	A	R	A		
K	R	I	T	S	E	R	I	T	E	T		
T	E	M	E	B	E	L	L					
O	T	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
M	A	R	I	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	T	E	P	R	M	I	T	E	
I	N	A	T	U	M	A	D	T	E	S		
S	T	U	S	E	N	D	E	R	E	A		
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	A	U	
E	N	K	E	N	D	I	M	I	S			
R	A	A	F	J	O	E	B	E	L	A		
I	T	A	A	A	N	N	A	K	I			
O	K	A	N	A	I	S	A	R	N	A		
Z	E	L	L	I	L	I	M	E	D			
E	B	A	R	I	T	O	N	T	O	R		
T	O	K	A	A	L	N	L	E	R	A		
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R	

FJALËKRYQI (1)



Argëtim filozofik

- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta.
 - Asgjë nuk është më e shtrenjtë, se sa ajo që blihet me lutje...!
 - Nëse asnjë s'të ka zili, dije se ti je njëri i dështuar. Pema me kokrra synohet, tjetra harrohet...
 - Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u bie.
- (Ralf Valdo Emerson)

Thënie të mençura

- Nuk e dij cili është celesti i suksesit, por celesti i dëshirimit është te mundohesh te kenaqesh çdokënd. **Bill Cosby (1937 -)**
- Çlartë është paraja? Një njëri është i suksesshem nese zgjohet ne mengjes dhe bie te fleje ne darke, dhe ne mes ketyre djave ben ate qe dëshiron te beje. **Bob Dylan (1941 -)**
- Kurrë nuk janë të vetmuar ata që shoqërohen me mendime fisnike. (**Filip Sidnei**)
- "Kur shikoj prapa në të gjitha ato shqetësime, e kujtoj historinë e plakut të vjetër në shtratin e vdekjes, i cili kishte shumë shqetësime në jetën e tij, shumica e të cilave kurrë nuk kanë ndodhur"- **Winston Churchill**

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

